

# Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 36

## Zhvlerësimi i Aktiveve

### Objektivi

- 1 Objektivi i këtij Standardi është të përshkruajë procedurat që duhet të zbatohet një njësi ekonomike për të siguruar që aktivet e saj paraqiten me një vlerë jo më të madhe se vlera e rikuperueshme e tyre. Një aktiv mbahet me një vlerë më të madhe se vlera e rikuperueshme nëse vlera kontabël e tij tejkalon shumën që do të përfitohet nga përdorimi ose shitja e aktivit. Në një rast të tillë, aktivi përshkruhet si i zhvlerësuar dhe Standardi kërkon që njësi ekonomike të njohë një humbje nga zhvlerësimi. Gjithashtu Standardi përcakton se kur duhet t'a anulohet njësi ekonomike një humbje nga zhvlerësimi dhe përcakton dhënien e informacioneve shpjeguese.

### Qëllimi

- 2 Ky Standard duhet të zbatohet për trajtimin kontabël të zhvlerësimit të të gjitha aktiveve me përjashtim të:
- (a) inventarëve (shih SNK 2 *Inventarët*);
  - (b) aktivet që krijohen nga kontratat e ndërtimit (shih SNK 11 *Kontratat e Ndërtimit*);
  - (c) aktivet për tatime të shtyra (shih SNK 12 *Tatimet mbi të Ardhurat*);
  - (d) aktivet që rrjedhin nga përfitimet e punonjësve (shih SNK 19 *Përfitimet e Punonjësve*);
  - (e) aktivet financiare të cilat përfshihen në objektin e SNK 39 *Instrumentet financiare: Njohja dhe Matja*;
  - (f) investimet në pasuri të palujtshme që maten me vlerën e drejtë (shih SNK 40 *Aktivët pwr Investim*);
  - (g) aktivet biologjike të lidhura me veprimtarinë bujqësore të cilat maten me vlerën e drejtë minus kostot e çmuara në pikën e shitjes (shih SNK 41 *Bujqësia*);
  - (h) kostot e shtyra të blerjes dhe aktivet jo-materiale, që rrjedhin nga të drejtat kontraktuale të siguruesit sipas kontratave të sigurimit brenda objektit të SNRF 4 *Kontratave të sigurimeve*; dhe
  - (i) aktivet afatgjata (ose grupet e hequra) të klasifikuara si të mbajtura për shitje në përputhje me SNRF 5 *Aktivët afatgjata të mbajtura për shitje dhe operationet e ndërprera*;
- 3 Ky Standard nuk zbatohet për inventarët, aktivet që vijnë nga kontratat e ndërtimit, aktivet nga tatimet e shtyra, aktivet që vijnë nga përfitimet e punonjësve ose aktivet e klasifikuara si të mbajtura për shitje (ose të përfshira në një grup për t'u nxjerrë jashtë përdorimit që është klasifikuar për shitje) sepse SNRF-të ekzistuese të zbatueshme për këto aktive përmbajnë kërkesa për njohjen dhe matjen e këtyre aktiveve.
- 4 Ky Standard zbatohet për aktivet financiare që klasifikohen si:
- (a) filiale sipas përcaktimit në SNK 27 *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe të Veçanta*;
  - (b) pjesëmarrje sipas përcaktimit në SNK 28 *Investimet në Njësi të Lidhura*; dhe
  - (c) sipërmarrje të përbashkëta sipas përcaktimit në SNK 31 *Interesat në Sipërmarrjet e Përbashkëta*.

SNK 39 trajton zhvlerësimin e aktiveve të tjera financiare.

- 5 Ky Standard nuk zbatohet për aktivet financiare objekt i SNK 39, aktivet pwr investim të matura me vlerën e drejtë në përputhje me SNK 40 ose aktivet biologjike të lidhura me aktivitetin bujqësor të matura me vlerën e drejtë minus kostot e shitjes në përputhje me SNK 41. Megjithatë ky Standard zbatohet për aktivet që mbahen me shumën e rivlerësuar (dmth vlerën e drejtë) në përputhje me SNRF-të e tjera, si psh modeli i rivlerësimit i SNK 16 *Aktivët Afatgjata Materiale*. Identifikimi nëse një aktiv i rivlerësuar mund të jetë zhvlerësuar varet nga baza e përdorur për të përcaktuar vlerën e drejtë:

- (a) nëse vlera e drejtë e aktivit është vlera e tij e tregut, vetëm diferenca mes vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës së tij të drejtë minus kostot e shitjes, është kosto direkte rritëse e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktivit:
- (i) nëse kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit janë të papërfillshme, shumata e rikuperueshme e aktivit të rivlerësuar është patjetër afër ose më e madhe se vlera e rivlerësuar e tij (dmth vlera e drejtë). Në këtë rast pas zbatimit të kërkesave për rivlerësim ka pak mundësi që aktivi i rivlerësuar të zhvlerësohet dhe nuk nevojitet që të vlerësohet shumata e rikuperueshme.
  - (ii) nëse kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit nuk janë të papërfillshme, vlera e drejtë minus kostot e shites së aktivit të rivlerësuar është patjetër më e vogël se vlera e drejtë e tij. Prandaj aktivi i rivlerësuar do të zhvlerësohet nëse vlera e tij në përdorim është më e vogël sesa shumata e rivlerësuar e tij (dmth vlera e drejtë). Në këtë rast pas zbatimit të kërkesave për rivlerësim një njësi ekonomike zbaton këtë Standard për të përcaktuar nëse aktivi mund të jetë çvlerësuar.
- (b) nëse vlera e drejtë e aktivit përcaktohet mbi baza të ndryshme nga vlera e tregut, shumata e rivlerësuar e aktivit (dmth vlera e drejtë) mund të jetë më e madhe ose më e vogël sesa shumata e rikuperueshme të tij. Prandaj pas zbatimit të kërkesave për rivlerësim, një njësi ekonomike zbaton këtë Standard për të përcaktuar nëse aktivi mund të jetë zhvlerësuar.

## Përkufizime

6 Termat në vijim përdoren në këtë Standard me kuptimet e cilësuar:

*Një treg aktiv* është një treg në të cilin ekzistojnë kushtet në vijim:

- (a) zërat e tregtuar brenda tregut janë homogjenë;
- (b) në çdo kohë mund të gjenden blerës dhe shitës të interesuar; dhe
- (c) zakonisht çmimet janë të disponueshme për publikun.

*Vlera kontabël neto* është shumata me të cilën njihet një aktiv pas zbritjes së amortizimit të akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi i tij.

*Një njësi gjeneruese e mjeteve monetare* është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që krijon flukse hyrëse monetare të cilat janë shumë të pavarura nga flukset hyrëse monetare të aktiveve të tjera ose grupeve të tjera të aktiveve.

*Aktivet e shoqërisë* janë aktive të ndryshme nga emri i mirë që kontribuojnë në flukset e ardhshme monetare si në njësinë gjeneruese të mjeteve monetare në analizë dhe në njësitë e tjera që krijojnë mjete monetare.

*Kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit* janë kostot rritëse që i takojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë nxjerrjes jashtë përdorimit të një aktivi ose njësie gjeneruese të mjeteve monetare, përjashtuar kostot financiare dhe shpenzimet për tatimin mbi të ardhurat.

*Shumata e amortizueshme* është kosto e një aktivi ose shumë tjetër zëvendësues e kostos në pasqyrat financiare, minus vlerën e mbetur.

*Amortizimi (zhvlerësimi)* është shpërndarja sistematike e shumës së amortizueshme të një aktivi përgjatë jetës së dobishme të tij.\*

*Vlera e drejtë minus kostot e shitjes* është shumata që merret nga shitja e një aktivi ose njësie gjeneruese të mjeteve monetare në një transaksion mes palëve të mirëinformuara, të palidhura, minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit.

*Humbje nga zhvlerësimi* është shumata për të cilën vlera kontabël neto e aktivit ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon shumën e tij të rikuperueshme.

*Shumata e rikuperueshme* e një aktivi ose njësie gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja mes vlerës së drejtë të tij minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim.

*Jeta e dobishme* është ose:

- (a) periudha gjatë së cilës një aktiv pritët të përdoret nga njësi ekonomike; ose

\* Në rastin e një aktivi afatgjatë jomaterial, zakonisht përdoret termi 'amortizim' në vend të 'zhvlerësim'. Të dy termat kanë të njëjtin kuptim.

- (b) **sasia e njërive të prodhuara ose njërive të ngjashme të pritshme për të marrë prej aktivit nga njësia ekonomike.**

*Vlera në përdorim është vlera aktuale e flukseve të ardhshme monetare të pritshme që të vijnë nga aktiviteti ose njësi gjeneruese të mjeteve monetare.*

## **Identifikimi i një aktivi që mund të çvlerësohet**

- 7 Paragrafët 8–17 specifikojnë se kur duhet të përcaktohet shuma e rikuperueshme. Në këto kërkesa përdoret termi ‘një aktiv’ por zbatohen njëjloj si për një aktiv individual dhe për një njësi gjeneruese të mjeteve monetare. Pjesa e mbetur e këtij Standardi strukturohet si vijon:
- (a) paragrafët 18–57 paraqesin kërkesat për matjen e shumës së rikuperueshme. Edhe në këto kërkesa përdoret termi ‘një aktiv’ por zbatohen njëjloj si për një aktiv individual dhe për një njësi gjeneruese të mjeteve monetare.
- (b) paragrafët 58–108 paraqesin kërkesat për njohjen dhe matjen e humbjes nga çvlerësimi. Njohja dhe matja e humbjes nga çvlerësimi për aktivet individuale të ndryshme nga emri i mirë trajtohet në paragrafët 58–64. Paragrafët 65–108 trajtojnë njohjen dhe matjen e humbjes nga çvlerësimi për njësitë gjeneruese të mjeteve monetare dhe emri i mirë.
- (c) paragrafët 109–116 paraqesin kërkesat për rimarrjen e një humbje të njohur nga çvlerësimi në periudhat e mëparëshme për një aktiv ose një njësi që gjeneron mjete monetare. Edhe këto kërkesa përdorin termin “një aktiv” por zbatohen njëjloj si për një aktiv dhe për një njësi gjeneruese të mjeteve monetare. Kërkesat shitesë për një aktiv individual paraqiten në paragrafët 117–121, për një njësi gjeneruese të mjeteve monetare në paragrafët 122 dhe 123 dhe për emrin e mirë në paragrafët 124 dhe 125.
- (d) paragrafët 126–133 specifikojnë informacionin që duhet të paraqitet në shënimet shpjeguese mbi humbjet nga çvlerësimi dhe rimarrjet e humbjeve nga çvlerësimi për aktivet dhe njësitë gjeneruese të mjeteve monetare. Paragrafët 134–137 specifikojnë kërkesa shitesë për dhënie informacionesh shpjeguese për njësitë gjeneruese të mjeteve monetare për të cilat emri i mirë ose aktivet afatgjata materiale me jetë të dobishme të papërcaktuar janë shpërndarë për efekt të testimit për çvlerësim.
- 8 Një aktiv çvlerësohet nëse vlera kontabël neto e tij tejkalon shumën e rikuperueshme. Paragrafët 12–14 përshkruajnë disa tregues të ndodhjes së humbjes nga çvlerësimi. Nëse është i pranishëm ndonjë nga këta tregues, njësi ekonomike duhet të bëjë një vlerësim formal të shumës së rikuperueshme. Me përjashtim të përcaktimit në paragrafin 10, ky Standard nuk kërkon që një njësi ekonomike të bëjë një vlerësim formal të shumës së rikuperueshme nëse nuk është i pranishëm ndonjë nga treguesit e humbjes nga çvlerësimi.
- 9 **Një njësi ekonomike duhet të vlerësojë në fund të çdo periudhe raportimi nëse ka ndonjë tregues që një aktiv mund të jetë çvlerësuar. Nëse është i pranishëm një tregues i tillë, njësi ekonomike duhet të vlerësojë shumën e rikuperueshme të aktivitetit.**
- 10 **Pavarësisht nëse është i pranishëm ose jo një tregues çvlerësimi, një njësi ekonomike duhet të:**
- (a) **testojë çdo vit për çvlerësim një aktiv afatgjatë jomaterial me jetë të dobishme të papërcaktuar ose një aktiv afatgjatë jomaterial ende jo të disponueshëm, duke krahasuar vlerën kontabël neto të tij me vlerën e rikuperueshme të tij. Ky test çvlerësimi mund të kryhet në çdo kohë gjatë vitit, me kusht që të kryhet në të njëjtën kohë çdo vit. Aktive të ndryshme afatgjata jomateriale mund të testohen për çvlerësim në momente kohore të ndryshme. Megjithatë nëse një aktiv i tillë afatgjatë jomaterial është njohur për herë të parë gjatë periudhës aktuale, ky aktiv afatgjatë jomaterial duhet të testohet për çvlerësim para fundit të periudhës aktuale vjetore.**
- (b) **testojë çdo vit për çvlerësim emrin e mirë të siguruar në një kombinim biznesi në përputhje me paragrafët 80–99.**
- 11 Aftësia e një aktivi afatgjatë jomaterial për të krijuar përfitime ekonomike të ardhshme të mjaftueshme për të mbuluar vlerën e tij kontabël neto, zakonisht është objekt i një pasigurie më të madhe para se aktivi të jetë gati për përdorim sesa kur ai është gati për përdorim. Prandaj ky Standard kërkon që një njësi ekonomike të testojë për çvlerësim të paktën një herë në vit, vlerën kontabël neto të një aktivi afatgjatë jomaterial që nuk është ende në përdorim.
- 12 **Gjatë vlerësimit nëse një aktiv mund të jetë i çvlerësuar, një njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë të paktën treguesit në vijim:**

Burimet e jashtme të informacionit

- (a) gjatë periudhës, vlera e tregut e një aktivi ka rënë në mënyrë të ndjeshme më shumë sesa pritej si pasojë e kalimit të kohës ose përdorimit normal.
- (b) gjatë periudhës në njësinë ekonomike kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme me efekt të kundërt ose do të ndodhin në të ardhmen e afërt, në mjedisin teknologjik, tregtar, ekonomik ose ligjor në të cilin vepron njësi ekonomike ose në tregun në të cilin tregtohet aktivi.
- (c) normat e interesit të tregut ose normat e kthimit të investimeve në tregjet e tjera janë rritur gjatë periudhës dhe këto rritje ka mundësi që të ndikojnë normën e skontimit të përdorur në llogaritjen e vlerës në përdorim të aktivitetit dhe të zvogëlojnë ndjeshëm vlerën e rikuperueshme të aktivitetit.
- (d) vlera kontabël neto e aktiveve neto të njësisë ekonomike është më e madhe sesa vlera e saj e kapitalizuar në treg.

#### Burimet e brendshme të informacionit

- (e) disponohet evidencë se një aktiv është nxjerrë nga përdorimi ose është i dëmtuar fizikisht.
- (f) ndryshime të rëndësishme me efekt negativ mbi njësinë ekonomike kanë ndodhur gjatë periudhës ose pritet të ndodhin në një të ardhme të afërt në madhësinë ose mënyrën sesi përdoret një aktiv ose pritet që të përdoret. Këto ndryshime përfshijnë bërjen gati të aktivitetit, planet për ndërprerjen ose ristrukturimin e aktivitetit të cilit i përket aktivitetit, planet për të nxjerrë nga përdorimi një aktiv para datës së pritshme dhe rivlerësimin e jetës së dobishme të një aktivi si të fundme dhe jo të fundme.\*
- (g) disponohet evidencë nga raportimi i brendshëm që tregon se performanca ekonomike e një aktivi është ose do të jetë më e keqe sesa pritej.

#### Dividendë nga një filial, sipërmarrje e përbashkët apo pjesëmarrje

- (h) për një investim në një filial, njësi ekonomike të bashkëkontrolluar ose pjesëmarrje, investitori njih një dividend nga investimi dhe disponon evidencë se:
  - (i) vlera kontabël neto e investimit në pasqyrat financiare të veçanta tejkalon vlerën kontabël në pasqyrat financiare të konsoliduara të aktiveve neto të të investuarit, përfshirë emrin e mirë përkatës; ose
  - (ii) dividendi tejkalon të ardhurat gjithsej të filialit, të njësisë ekonomike të bashkëkontrolluar ose të pjesëmarrjes në periudhën kur deklarohet dividendi.

- 13 Lista në paragrafin 12 nuk është përjashtuese. Një njësi ekonomike mund të identifikojë tregues të tjerë për çylerësimin e një aktivi. Edhe ata mund të kërkojnë që njësi ekonomike të përcaktojë vlerën e rikuperueshme të aktivitetit ose në rastin e emrit të mirë të kryejë një test çylerësimi në përputhje me paragrafët 80–99.
- 14 Evidenca nga raportimi i brendshëm që tregon se një aktiv mund të jetë çylerësuar përfshin ekzistencën e:
- (a) flukseve monetare për sigurimin e aktivitetit ose nevoja për mjete monetare më vonë për përdorimin ose mirëmbajtjen e tij, të cilat janë shumë më të mëdha sesa ato të parashikuara fillimisht në buxhet;
  - (b) flukset neto monetare aktuale ose fitimi ose humbja operativ (të shfrytëzimit) që vijnë nga aktivi janë shumë më keq sesa ato të buxhetuara;
  - (c) një rënie e rëndësishme në flukset neto monetare të buxhetuara ose fitimin operativ (të shfrytëzimit) ose një rritje e rëndësishme në humbjet e buxhetuara që vijnë nga aktivi; ose
  - (d) humbjet operative (të shfrytëzimit) ose flukset dalëse neto monetare për aktivin, kur shumat e periudhës aktuale janë bashkuar me shumat e buxhetura për të ardhmen.
- 15 Siç tregohet në paragrafin 10, ky Standard kërkon që një aktiv afatgjatë jomaterial me jetë të dobishme të papërcaktuar ose jo gati për përdorim dhe emri i mirë të testohen për çylerësim, të paktën një herë në vit. Përveç rastit kur zbatohen kërkesat e paragrafit 10, për të identifikuar nëse shuma e rikuperueshme e aktivitetit duhet të vlerësohet zbatohet koncepti i materialitetit. Për shembull nëse llogaritjet e mëparëshme tregojnë se vlera e rikuperueshme e një aktivi është shumë më e madhe sesa vlera kontabël neto e tij, njësi ekonomike nuk ka nevojë të rivlerësojë shumën e rikuperueshme të aktivitetit nëse nuk ka ndodhur ndonjë ngjarje që mund të eliminojë këtë diferencë. Në mënyrë të ngjashme analiza e mësipërme mund të tregojë se shuma e

\* Kur një aktiv plotëson kriterin për t'u klasifikuar si i mbajtur për shitje (ose përfshihet në një grup që nxirret nga përdorimi që klasifikohet si i mbajtur për shitje) ai përjashtohet nga objekti i këtij Standardi dhe trajtohet në përputhje me SNRF 5 *Aktivet Afatgjata të Mbajtura për Shitje dhe Veprimtaritë e Ndërprera*.

rikuperueshme e një aktivi të mos jetë e ndjeshme ndaj një (ose më shumë) treguesi (treguesve) të radhitur në paragrafin 12.

- 16 Për të ilustruar paragrafin 15, nëse normat e interesit të tregut ose normat e kthimit nga investimet në tregjet e tjera janë rritur gjatë periudhës, një njësi ekonomike nuk i kërkohet të bëjë një vlerësim formal të shumës së rikuperueshme të një aktivi në rastet në vijim:
- (a) nëse norma e skontimit e përdorur në llogaritjen e vlerës në përdorim të aktivit ka pak mundësi të ndikohet nga rritja në këto norma tregu. Për shembull rritja në normat e interesit afatshkurtër mund të mos ketë efekt material në normën e skontimit të përdorur për një aktiv që ka një jetë të dobishme të gjatë.
  - (b) nëse norma e skontimit e përdorur në llogaritjen e vlerës në përdorim të aktiv ka mundësi të ndikohet nga rritja në këto norma tregu por analiza e mëparëshme e ndjeshmërisë për shumën e rikuperueshme tregon se:
    - (i) ka pak mundësi që do të ketë një rënie materiale në shumën e rikuperueshme për shkak se flukset monetare të ardhshme ka mundësi që edhe ato të rriten (p.sh. në disa raste një njësi ekonomike mund të jetë në gjendje të provojë se mund të sistemojë të ardhurat për të kompensuar çdo rritje në normat e tregut); ose
    - (ii) rënia në shumën e rikuperueshme ka pak mundësi që të sjellë një humbje materiale nga çvlerësimi.
- 17 Nëse ka një tregues që aktivi mund të jetë çvlerësuar kjo mund të tregojë se jeta e dobishme e mbetur, metoda e zhvlerësimit (amortizimit) ose vlera e mbetur e aktivit ka nevojë të rishihet dhe të sistemohet në përputhje me Standardin e zbatueshëm për aktivin, edhe nëse nuk është njohur ndonjë humbje nga çvlerësimi për aktivin.

## Matja e shumës së rikuperueshme

- 18 Ky Standard përcakton shumën e rikuperueshme si më të madhen mes vlerës së drejtë të një aktivi ose njësie gjeneruese të mjeteve monetare, minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Paragrafët 19–57 paraqesin kërkesat për matjen e shumës së rikuperueshme. Në këto kërkesa përdoret termi ‘një aktiv’ por zbatohen njëjllë si për aktivet individuale edhe për njësitë gjeneruese të mjeteve monetare.
- 19 Nuk është gjithmonë e nevojshme që të përcaktohen të duja, si vlera e drejtë minus kostot e shitjes së një aktivi ashtu dhe vlera e tij në përdorim. Nëse njëra nga këto shuma tejkalon vlerën kontabël neto të aktivit, aktivi nuk është i çvlerësuar dhe nuk është e nevojshme të vlerësohet shuma tjetër.
- 20 Është e mundshme të përcaktohet vlera e drejtë minus kostot e shitjes edhe nëse aktivi nuk tregtohet në një treg aktiv. Megjithatë ndonjëherë nuk do të jetë e mundur të përcaktohet vlera e drejtë minus kostot e shitjes sepse nuk ka baza për bërjen e një vlerësimi të besueshëm të shumës që mund të merret nga shitja e aktivit në një transaksion mes palëve të mirëinformuara dhe të palidhura. Në këtë rast njësi ekonomike mund të përdorë vlerën në përdorim të aktivit si shumën e rikuperueshme të tij.
- 21 Nëse nuk ka arsye të besohet se vlera në përdorim e një aktivi tejkalon shumë vlerën e tij të drejtë minus kostot e shitjes, vlera e drejtë minus kostot e shitjes së aktivit mund të përdoret si shuma e tij e rikuperueshme. Shpesh ky mund të jetë rasti i aktiveve të mbajtura për t’u nxjerrë nga përdorimi. Kjo sepse vlera në përdorim e një aktivi të mbajtur për t’u nxjerrë nga përdorimi do të përbëhet kryesisht nga të ardhurat neto nga nxjerrja nga përdorimi, pasi fluksi monetar i ardhshëm nga përdorimi në vijim i aktivit derisa të nxirret nga përdorimi është i papërfillshëm.
- 22 Shuma e rikuperueshme përcaktohet për një aktiv individual me përjashtim të rastit kur aktivi krijon flukse hyrëse monetare të cilat nuk janë shumë të pavarura nga ato të krijuara nga aktive të tjera ose grupe të tjera aktivesh. Në këtë rast shuma e rikuperueshme përcaktohet për njësinë gjenerues të mjeteve monetare të cilës i përket aktivi (shih paragrafët 65–103), me përjashtim të rastit kur:
- (a) vlera e drejtë minus kostot e shitjes së aktivit është më e madhe sesa vlera e tij kontabël neto; ose
  - (b) vlera në përdorim e aktivit mund të vlerësohet si e afërt me vlerën e drejtë minus kostot e shitjes dhe vlera e drejtë minus kostot e shitjes mund të përcaktohet.
- 23 Në disa raste vlerësimet, mesataret dhe llogaritjet e shpejta mund të sigurojnë përafrime të arsyeshme mbi llogaritjet e detajuara të ilustruara në këtë Standard për përcaktimin e vlerës së drejtë minus kostot e shitjes ose të vlerës në përdorim.

## Matja e shumës së rikuperueshme nga një aktiv afatgjatë jomaterial me jetë të dobishme të papërcaktuar

- 24 Paragrafi 10 kërkon që një aktiv afatgjatë jomaterial me jetë të dobishme të papërcaktuar të testohet për çvlerësim çdo vit duke krahasuar vlerën kontabël neto të tij me shumën e tij të rikuperueshme, pavarësisht nëse ka ndonjë tregues që ai mund të jetë çvlerësuar. Megjithatë llogaritjet më të fundit të detajuara për shumën e rikuperueshme të një aktivi të tillë të bëra në periudhën e shkuar mund të përdoren në testin e çvlerësimit të atij aktivi në periudhën aktuale me kushtin që të plotësohen të gjitha kriteret në vijim:
- (a) nëse aktivi afatgjatë jomaterial nuk krijon flukse hyrëse monetare nga përdorimi i vazhdueshëm të cilat të jenë të pavarura nga ato të krijuara nga aktivet e tjera ose grupet e aktiveve dhe për këtë testohet për çvlerësim si pjesë e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare të cilës I përket, aktivet dhe pasivet që përbëjnë këtë njësi nuk kanë ndryshuar shumë që nga llogaritja më e fundit e shumës së rikuperueshme;
  - (b) llogaritjen më të fundit të shumës së rikuperueshme që sjell një shumë që tejkalon vlerën kontabël neto të aktivit me një marzh të rëndësishëm; dhe
  - (c) bazuar në një analizë të ngjarjeve që kanë ndodhur dhe rrethanave që kanë ndryshuar që prej llogaritjes më të fundit të shumës së rikuperueshme, është e largët mundësia që ky përcaktim aktual i shumës së rikuperueshme të jetë më e vogël sesa vlera kontabël neto e aktivit.

## Vlera e drejtë minus kostot e shitjes

- 25 Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një aktivi minus kostot e shitjes është çmimi në një marrëveshje detyruese shitjeje në një transaksion mes palëve të palidhura, i rregulluar për kostot rritëse që lidhen drejtpërdrejt me nxjerrjen nga përdorimi të aktivit.
- 26 Nëse nuk ka ndonjë marrëveshje detyruese shitjeje por aktivi tregtohet në një treg aktiv, vlera e drejtë minus kostot e shitjes është çmimi i tregut i aktivit minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit. Çmimi i duhur i tregut, zakonisht është çmimi aktual ofertë. Nëse nuk disponohen çmime ofertë, çmimi i transaksionit më të fundit mund të jetë baza për të vlerësuar vlerën e drejtë minus kostot e shitjes me kushtin që nuk ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në rrethanat ekonomike mes datës së transaksionit dhe datës në të cilën bëhet vlerësimi.
- 27 Nëse nuk ka ndonjë marrëveshje detyruese shitjeje ose treg aktiv për një aktiv, vlera e drejtë minus kostot e shitjes bazohet në informacionin më të mirë të disponueshëm për të pasqyruar shumën që mund të marrë njësi ekonomike në fund të periudhës së raportimit nga nxjerrja nga përdorimi e aktivit në një transaksion mes palëve të palidhura dhe të mirëinformuara pas zbritjes së kostove të nxjerrjes nga përdorimi. Në përcaktimin e kësaj shume, njësi ekonomike merr në konsideratë rezultatet e transaksioneve më të fundit për aktive të ngjashme brenda industrisë. Vlera e drejtë minus kostot e shitjes nuk pasqyron një shitje të detyruar, përveçse kur drejtimi është i detyruar ta shesë menjëherë.
- 28 Kostot e nxjerrjes nga përdorimi të tjera nga ato të njohura si pasive zbriten në përcaktimin e vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Shembuj të kostove të tilla janë kostot ligjore, taksa e pullës dhe taksa të ngjashme të transaksioneve, kostot e lëvizjes së aktivit dhe kostot rritëse të drejtpërdrejta për të sjellë aktivin në kushtet e shitjes. Megjithatë përfitimet e përfundimit të punësimit (sipas përcaktimit SNK 19) dhe kostot e lidhura me pakësimin ose riorganizmin e biznesit pas nxjerrjes nga përdorimi të një aktivi nuk janë kosto rritëse të drejtpërdrejta të nxjerrjes nga përdorimi të një aktivi.
- 29 Ndonjëherë nxjerrja nga përdorimi i një aktivi kërkon që blerësi të marrë përsipër një pasiv dhe vetëm një vlerë e drejtë minus kostot e shitjes është e disponueshme për aktivin dhe pasivin. Paragrafi 78 shpjegon sesi trajtohen raste të tilla.

## Vlera në përdorim

- 30 Elementët në vijim duhet të pasqyrohen në llogaritjen e vlerës në përdorim të një aktivi:
- (a) një vlerësim i fluksit monetar të ardhshëm që pret të marrë njësi ekonomike nga aktivi;
  - (b) pritjet rreth ndryshimeve të mundshme në shumën ose kohën e këtyre flukseve të ardhshme monetare;
  - (c) vlerën në kohë të parasë, të paraqitur nga normat aktuale të interesit pa risk të tregut;
  - (d) çmimi i përballjes së pasigurisë së pranishme në aktiv; dhe
  - (e) faktorë të tjerë si mungesa e likuiditetit që pjesëmarrësit në treg do të pasqyrojnë në vlerësimin e fluksve të ardhshme monetare që pret të marrë nga aktivi njësi ekonomike.

- 31 Vlerësimi i vlerës në përdorim të një aktivi përfshin hapat në vijim:
- (a) vlerësimin e flukseve hyrëse dhe dalëse monetare të ardhshme që do të rrjedhin nga përdorimi i vazhdueshëm i aktivitetit dhe nga nxjerra e tij nga përdorimi në fund; dhe
  - (b) përdorimi i një norme të përshtatshme skontimi për këto flukse monetare të ardhshme.
- 32 Elementët e identifikuar në paragrafët 30(b), (d) dhe (e) mund të pasqyrohen ose si rregullime të flukseve monetare të ardhshme ose si rregullime të normës së skontimit. Pavarësisht nga metoda që zbaton një njësi ekonomike për të pasqyruar pritshmërinë rreth ndryshimeve të mundshme në shumën ose kohën e flukseve monetare të ardhshme, rezultati duhet të pasqyrojë vlerën aktuale të pritshme të flukseve monetare të ardhshme, dmth mesatarja e ponderuar e të gjitha rezultateve të mundshme. Shtojca A paraqet udhëzime shtesë për përdorimin e teknikës së vlerës aktuale në matjen e vlerës në përdorim të një aktivi.

### Baza për vlerësimin e flukseve të ardhshme në mjete monetare

- 33 Në matjen e vlerës në përdorim një njësi ekonomike duhet të:
- (a) **mbështesë parashikimet për flukset monetare në supozime të arsyeshme dhe të bazuara të cilat përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit për një sërë kushtesh ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të mbetur të aktivitetit. Evidencës nga jashtë i duhet dhënë një peshë më e madhe.**
  - (b) **mbështesë parashikimet për flukset monetare në buxhetet/parashikimet financiare më të fundit të miratuara nga drejtimi por duhet të përjashtojë çdo fluks monetar të parashikuar të ardhshëm hyrës ose dalës që pritet të vijë nga ristrukturime të ardhshme ose nga përmirësimi apo rritja e performancës së aktivitetit. Parashikimet e mbështetura në këto buxhete/parashikime duhet të mbulojnë një periudhë maksimale për pesë vite, me përjashtim të rastit kur mund të justifikohet një periudhë më e gjatë.**
  - (c) **vlerësojë parashikimet për flukset monetare përtej periudhës së mbuluar nga buxhetet/parashikimet më të fundit duke ekstrapoluar (përlllogaritur) parashikimet bazuar në buxhetet/parashikimet duke përdorur një normë rritjeje të qëndrueshme ose rënësë për vitet në vijim, me përjashtim të rastit kur mund të justifikohet përdorimi i një norme rritjeje. Kjo normë rritjeje nuk duhet të tejkalojë normën mesatare të rritjes në periudha afatgjata për produktet, industrinë, ose vendin apo vendet në të cilën vepron njësi ekonomike ose për tregun në të cilin përdoret aktivi me përjashtim të rastit kur mund të justifikohet përdorimi i një norme më të lartë.**
- 34 Drejtimi vlerëson pranueshmërinë e supozimeve mbi të cilat janë bazuar parashikimet e tij për flukset aktuale monetare duke analizuar shkaqet e diferencave mes parashikimeve për flukset e kaluara monetare dhe flukseve aktuale monetare. Drejtimi duhet të sigurojë se supozimet mbi të cilat mbështeten parashikimet e tij për flukset monetare aktuale janë në pajtim me rezultatet aktuale të së shkuarës, me kushtin që efektet e ngjarjeve ose rrethanave pasuese që nuk ekzistojnë në kohën e krijimit të këtyre flukseve aktuale monetare e bëjnë këtë të mundshme (përshtatshme).
- 35 Zakonisht nuk janë të disponueshme buxhete/parashikime financiare të detajuara, të qarta dhe të besueshme për periudha më të gjata se pesë vjet. Për këtë arsye vlerësimet e drejtimit për flukset e ardhshme monetare mbështeten në buxhetet/parashikimet më të fundit për një periudhë maksimumi prej pesë vitesh. Drejtimi mund të përdorë parashikimet e flukseve monetare të bazuara në buxhetet/parashikimet financiare për një periudhë më të gjatë se pesë vjet nëse beson se këto parashikime janë të besueshme dhe nëse mund të tregojë aftësinë e tij, bazuar në eksperiencën e shkuar, se mund të parashikojë flukset monetare në mënyrë të saktë për këtë periudhë më të gjatë.
- 36 Parashikimet për flukset monetare deri në fund të jetës së dobishme të një aktivi vlerësohen duke përlllogaritur parashikimet për flukset monetare bazuar në buxhetet/parashikimet financiare duke përdorur një normë rritjeje për vitet në vijim. Kjo normë është e qëndrueshme ose rënësë, me përjashtim të rastit kur një rritje në normë plotëson informacion objektiv lidhur me tiparet përgjatë jetës së një produkti ose industrie. Kur është e përshtatshme, norma e rritjes është zero ose negative.
- 37 Nëse kushtet janë të favorshme, ka mundësi që konkurrentët të hyjnë në treg dhe të zvogëlojnë rritjen. Prandaj njësitë ekonomike do t'a kenë të vështirë që të tejkalojnë normën mesatare historike të rritjes në periudha afatgjata (le të themi për njëzet vjet) për produkte, industri ose vend e vende në të cilën vepron njësi ekonomike ose në tregun në të cilin përdoret aktivi.
- 38 Kur përdor informacion nga buxhetet/parashikimet financiare një njësi ekonomike merr në konsideratë nëse informacioni pasqyron supozime të arsyeshme dhe të bazuara dhe nëse përfaqëson vlerësimin më të mirë të drejtimit mbi tërësinë e kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të mbetur të aktivitetit.

## Përbërja e vlerësimeve për flukset monetare të ardhshme

- 39 **Vlerësimet për flukset monetare të ardhshme duhet të përfshijnë:**
- (a) **parashikimet për flukset hyrëse monetare nga përdorimi i vazhdueshëm i aktivitetit;**
  - (b) **parashikimet për flukset dalëse monetare që bëhen domosdoshmërisht për të krijuar flukse hyrëse monetare nga përdorimi i vazhdueshëm i aktivitetit (përfshirë flukset dalëse monetare për përgatitjen e aktivitetit për përdorim) dhe që mund t'i takojnë drejtpërdrejt aktivitetit ose që mund të shpërndahen mbi baza të arsyeshme dhe të qëndrueshme tek ai; dhe**
  - (c) **flukset monetare neto, nëse ka, që pritet të merren (ose paguhen) për nxjerrjen nga përdorimi të aktivitetit në fund të jetës së tij të dobishme.**
- 40 Vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme dhe normës së skontimit reflektojnë supozimet e qëndrueshme rreth rritjeve të çmimit për shkak të inflacionit të përgjithshëm. Prandaj nëse norma e skontimit përfshin efektin e rritjes së çmimit për shkak të inflacionit të përgjithshëm, flukset monetare të ardhshme vlerësohen në terma nominalë. Nëse norma e skontimit përjashton efektin e rritjes së çmimeve për shkak të inflacionit të përgjithshëm, flukset monetare të ardhshme vlerësohen në terma realë (por përfshijnë rritje ose rënie specifike të ardhshme të çmimit).
- 41 Parashikimet e fluksve dalëse monetare përfshijnë ato për shërbimin ditë-pas-dite të aktivitetit si dhe shpenzimet e tjera të përgjithshme të ardhshme që mund t'i ngarkohen drejtpërdrejt përdorimit të aktivitetit ose t'i shpërndahen mbi baza të arsyeshme dhe të qëndrueshme.
- 42 Nëse vlera kontabël neto e një aktivi nuk përfshin ende të gjitha flukset dalëse monetare që do të ndeshen para se aktivi të jetë gati për përdorim ose shitje, vlerësimi i flukseve dalëse monetare të ardhshme përfshin një vlerësim të çdo fluksi dalës monetar të ardhshëm që pritet të ndeshet para se aktivi të jetë gati për përdorim ose për shitje. Për shembull ky është rasti i një ndërtese në ndërtim e sipër ose i një projekti në zhvillim që nuk është përfunduar ende.
- 43 Për të shmangur numërimin dy herë, vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme nuk përfshijnë:
- (a) flukset hyrëse monetare nga aktivitetet që krijojnë flukse hyrëse monetare mjaft të pavarura nga flukste hyrëse monetare të aktivitetit në fjalë (për shembull aktivitetet financiare si llogaritë e arkëtueshme); dhe
  - (b) flukset dalëse monetare që lidhen me detyrime që janë njohur si pasive (për shembull llogaritë e pagueshme, pensionet ose provizionet).
- 44 **Flukset monetare të ardhshme duhet të vlerësohen për aktivin në kushtet e tij aktuale. Vlerësimet për flukset monetare të ardhshme nuk duhet të përfshijnë flukset hyrëse ose dalëse monetare të ardhshme të vlerësuara që pritet të vijnë nga:**
- (a) **një ristrukturim të ardhshëm për të cilin njësi ekonomike nuk është angazhuar ende; ose**
  - (b) **përmirësimi ose rritja e performancës së aktivitetit.**
- 45 Për shkak se flukset e ardhshme monetare vlerësohen për aktivin në kushtet aktuale, vlera në përdorim nuk pasqyron:
- (a) flukset dalëse të ardhshme monetare ose që lidhen me kursimet e kostove (për shembull pakësimi i kostove të stafit) ose përfitimeve që pritet të vijnë nga një ristrukturim i ardhshëm për të cilin njësi ekonomike nuk është angazhuar ende; ose
  - (b) flukset dalëse të ardhshme monetare që do të përmirësojnë ose rrisin performancën e aktivitetit ose flukset hyrëse monetare përkatëse që pritet të vijnë nga flukse të tilla dalëse.
- 46 Një ristrukturim është një program i planifikuar dhe kontrolluar nga drejtimi dhe që ndryshon në mënyrë të rëndësishme qëllimin e biznesit të ndërmarrë një njësi ekonomike ose mënyrën si drejtohet biznesi. *SNK 37 Provizionet, Pasivet e Kushtëzuara dhe Aktivitetet e Kushtëzuara* përmban udhëzime mbi angazhimin e njësi ekonomike në një ristrukturim.
- 47 Nëse një njësi ekonomike angazhohet në një ristrukturim disa aktive ka mundësi që të ndikohen nga ky ristrukturim. Kur njësi ekonomike angazhohet në ristrukturim:
- (a) vlerësimet e saj për flukset hyrëse dhe dalëse të ardhshme monetare për përcaktimin e vlerës në përdorim, reflektojnë kursimet në kosto dhe përfitimet e tjera nga ristrukturimi (bazuar në buxhetet/parashikimet financiare më të fundit të miratuara nga drejtimi); dhe
  - (b) vlerësimet e saj për flukset dalëse të ardhshme monetare për ristrukturim përfshihen në një provizion për ristrukturim në përputhje me *SNK 37*.

Shembulli Ilustrues 5 tregon efektin e një ristrukturimi të ardhshëm në llogaritjen e vlerës në përdorim.



- 48 Derisa një njësi ekonomike të ndeshë flukse dalëse monetare që përmirësojnë ose rrisin performancën e aktivit, vlerësimet e flukseve të ardhshme monetare nuk përfshijnë flukset hyrëse të vlerësuara të ardhshme monetare që priten të vijnë nga një rritje në përfitimet ekonomike të lidhura me flukset dalëse monetare (shih Shembullin Ilustrues 6).
- 49 Vlerësimet e flukseve të ardhshme monetare përfshijnë flukset dalëse të ardhshme monetare të nevojshme për të ruajtur nivelin e pritshëm të përfitimeve ekonomike që do të vijnë nga aktivi në kushtet aktuale. Nëse një njësi gjeneruese të mjeteve monetare përbëhet nga aktive me jetë të dobishme të ndryshme, të gjitha thelbësore për vijueshmërinë e aktiviteteve të njësisë, zëvendësimi i aktiveve me jetë më të shkurtër konsiderohet si pjesë e shërbimit ditë pas dite të njësisë ndërsa vlerësohen flukset e ardhshme monetare të lidhura me njësinë. Në mënyrë të ngjashme nëse një aktiv i vetëm përbëhet nga përbërës me jetë të dobishme të vlerësuara të ndryshme, zëvendësimi i përbërësve me jetë më të shkurtër konsiderohet si pjesë e shërbimit ditë pas dite të aktivit kur vlerësohen flukset e ardhshme monetare të krijuara nga aktivi.
- 50 Vlerësimi i fluksve të ardhshme monetare nuk përfshin:**
- (a) **flukse hyrëse ose dalëse monetare nga aktivitetet financuese; ose**
- (b) **marrjet ose pagesat e tatimit mbi të ardhurat.**
- 51 Flukset e vlerësuara të ardhshme monetare pasqyrojnë supozimet se janë në përputhje me mënyrën sesi përcaktohet norma e skontimit. Përndryshe efekti i disa supozimeve do të llogarite dy herë ose nuk do të merret parasysh. Për shkak se vlera në kohë e parasë merret parasysh nëpërmjet skontimit të flukseve të vlerësuara të ardhshme monetare, këto flukse monetare përjashtojnë flukset hyrëse ose dalëse monetare nga aktivitetet financuese. Në mënyrë të ngjashme për shkak se norma e skontimit përcaktohet mbi baza para tatimit, flukset e ardhshme monetare vlerësohen mbi baza para tatimit.
- 52 Vlerësimi i flukseve monetare neto për t'u marrë (ose paguar) nga nxjerrja nga përdorimi e një aktivi në fund të jetës së tij të dobishme do të jetë shuma që një njësi ekonomike pret të marrë nga nxjerrja nga përdorimi e aktivit në një transaksion të pavarur mes palëve të mirëinformuara dhe të pëlidhura, pas zbritjes së kostove të vlerësuara për nxjerrjen nga përdorimi.**
- 53 Vlerësimi i flukseve monetare neto për t'u marrë (ose paguar) nga nxjerrja nga përdorimi e një aktivi në fund të jetës së tij të dobishme përcaktohet në mënyrë të ngjashme si vlera e drejtë e një aktivi minus kostot e shitjes me përjashtimin se në vlerësimin e këtyre flukseve monetare neto:
- (a) një njësi ekonomike përdor çmimet që mbizotërojnë në datën e vlerësimit për aktive të ngjashme që kanë mbëritur në fund të jetës së tyre të dobishme dhe janë përdorur në kushte të ngjashme me ato që do të përdoret aktivi.
- (b) njësi ekonomike rregullon këto çmime si për efektin e rritjes së ardhshme të çmimeve për shkak të inflacionit të përgjithshëm dhe për rritje ose ulje specifike të çmimit të ardhshëm. Megjithatë nëse vlerësimet e flukseve të ardhshme monetare nga përdorimi i vazhdueshëm i një aktivi dhe norma e skontimit përjashtojnë efektin e inflacionit të përgjithshëm, njësi ekonomike duhet të përjashtojë edhe këtë efekt nga vlerësimi i fluksit neto monetar në nxjerrjen nga përdorimi.

## **Flukset monetare të ardhshme në monedhë të huaj**

- 54 Flukset e ardhshme monetare vlerësohen në monedhën në të cilën ato do të krijohen dhe skontoen duke përdorur një normë të përshtatshme skontimi për atë monedhë. Një njësi ekonomike përkthen (konverton) vlerën aktuale duke përdorur normën spot të këmbimit në datën e llogaritjes së vlerës në përdorim.

## **Norma e skontimit**

- 55 Norma (normat) e skontimit duhet të jetë norma (normat) para tatimeve që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për:**
- (a) **vlerën në kohë të parasë; dhe**
- (b) **risqet specifike për aktivin për të cilat nuk janë rregulluar ende vlerësimet e flukseve të ardhshme monetare.**
- 56 Një normë që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike të aktivit është kthimi që do të kërkojnë investitorët nëse do të zgjedhin një investim që do të krijojë flukse monetare në shumë, kohë dhe natyrë risku të barasvlefshme me ato që njësi ekonomike pret të vijnë nga aktivi. Kjo normë vlerësohet nga norma e brendshme në transaksionet aktuale të tregut për aktive të ngjashme ose nga kosto mesatare e ponderuar e kapitalit e një njësie ekonomike të kuotuar që ka një aktiv të vetëm (ose një portofol aktivesh) të ngjashëm në terma të shërbimit të mundshëm dhe risqeve me aktivin në fjalë. Megjithatë norma e

skontimit e përdorur për të matur vlerën në përdorim të një aktivi nuk do të pasqyrojë risqet për të cilat janë rregulluar flukset e ardhshme monetare. Në rast të kundërt do të përfshihet dy herë efekti i disa supozimeve.

- 57 Nëse norma specifike e një aktivi nuk është e disponueshme drejtpërdrejt nga tregu, një njësi ekonomike përdor zëvendësues për të vlerësuar normën e skontimit. Shtojca A paraqet udhëzime shtesë mbi vlerësimin e normës së skontimit në raste të tilla.

## **Njohja dhe matja e humbjes nga çvlerësimi**

- 58 Paragrafët 59–64 paraqesin kërkesat për njohjen dhe matjen e humbjeve nga çvlerësimi i një aktivi individual të ndryshëm nga emri i mirë. Njohja dhe matja e humbjeve nga çvlerësimi për njësitë gjeneruese të mjeteve monetare dhe emrin e mirë trajtohen në paragrafët 65–108.
- 59 **Nëse dhe vetëm nëse, shuma e rikuperueshme e një aktivi është më e vogël se vlera kontabël neto e tij, vlera kontabël neto e aktivit duhet të pakësohet sa shuma e rikuperueshme. Ky pakësim është humbja nga çvlerësimi.**
- 60 **Një humbje nga çvlerësimi do të njihet menjëherë në fitimin ose humbjen e periudhës me përjashtim të rastit kur aktivi mbahet me shumën e rivlerësuar në përputhje me një Standard tjetër (për shembull, në përputhje me modelin e rivlerësimit në SNK 16). Çdo humbje nga çvlerësimi i aktivit të rivlerësuar duhet të trajtohet si rënie në rivlerësim në përputhje me atë Standard.**
- 61 Një humbje nga çvlerësimi e një aktivi jo-të rivlerësuar njihet në fitim ose humbje. Megjithatë një humbje nga çvlerësimi në aktivin e rivlerësuar njihet në të ardhurat e tjera gjithsej në madhësinë që humbja nga çvlerësimi nuk tejkalon shumën në tepricën e rivlerësimit për të njëjtin aktiv. Një humbje e tillë nga çvlerësimi në aktivin e rivlerësuar pakëson tepricën e rivlerësimit për këtë aktiv.
- 62 **Nëse shuma e rivlerësuar për një humbje nga çvlerësimi është më e madhe se vlera kontabël neto e aktivit të cilit i përket, një njësi ekonomike duhet të njohë një pasiv nëse, dhe vetëm nëse, kjo kërkohet nga një Standard tjetër.**
- 63 **Pas njohjes së një humbje nga çvlerësimi, madhësia e zhvlerësimit (amortizimit) të aktivit duhet të rregullohet në periudhat e ardhshme për të shpërndarë vlerën kontabël neto të rishikuar të aktivit, minus vlerën e mbetur të tij (nëse ka) mbi baza sistematike përgjatë jetës së dobishme të mbetur të tij.**
- 64 Nëse njihet një humbje nga çvlerësimi, çdo tatim i shtyrë aktiv ose pasiv përkatës përcaktohet në përputhje me SNK 12 duke krahasuar vlerën kontabël neto të rishikuar të aktivit me bazën e tij tatimore (shih Shembullin Ilustrues 3).

## **Njësitë gjeneruese të mjeteve monetare dhe emri i mirë**

- 65 Paragrafët 66–108 dhe Shtojca C paraqet kërkesat për identifikimin e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i përket aktivi dhe përcaktimin e vlerës kontabël neto dhe njohjes së humbjes nga çvlerësimi për njësitë gjeneruese të mjeteve monetare dhe emrin e mirë.

### **Identifikimi i njësisë gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i përket aktivi**

- 66 **Nëse ekziston ndonjë tregues që një aktiv është çvlerësuar, duhet të vlerësohet shuma e rikuperueshme për aktivin individual. Nëse nuk është e mundur që të vlerësohet shuma e rikuperueshme e aktivit individual, një njësi ekonomike duhet të përcaktojë shumën e rikuperueshme për njësinë gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i përket aktivi (njësinë gjeneruese të mjeteve monetare të aktivit).**
- 67 Shuma e realizueshme e një aktivi individual nuk mund të përcaktohet nëse:
- (a) vlera në përdorim e aktivit nuk mund të vlerësohet si afër vlerës së drejtë të tij minus kostot e shtitjes (për shembull, nëse flukset e ardhshme monetare nga përdorimi i vazhdueshëm i aktivit nuk vlerësohen si të papërfillshme); dhe
  - (b) aktivi nuk krijon flukse hyrëse monetare që janë shumë të pavaruara nga ato të aktiveve të tjera.
- Në raste të tilla, vlera në përdorim dhe për pasojë shuma e rikuperueshme mund të përcaktohet vetëm për njësinë gjeneruese të mjeteve monetare të aktivit.

**Shembull**

Një njësi ekonomike minerale zotëron një hekurudhë private për të mbështetur aktivitetet e saj minerale. Hekurudha private mund të shitet vetëm për vlerën e skrapit dhe nuk krijon flukse hyrëse monetare shumë të pavarura nga flukset hyrëse monetare nga aktivet e tjera të minierës.

*Nuk është e mundur që të vlerësohet shuma e realizueshme nga hekurudha private sepse nuk mund të përcaktohet vlera e saj në përdorim dhe që ka mundësi të jetë e ndryshme nga vlera e skrapit. Prandaj njësi ekonomike vlerëson shumën e rikuperueshme të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i përket hekurudha e private, dmth minierës si një e tërë.*

- 68 Siç përcaktohet në paragrafin 6, një njësi gjeneruese e mjeteve monetare e aktivitetit është grupi më i vogël i aktiveve që përfshin aktivin dhe krijon flukse hyrëse monetare që janë shumë të pavarura nga flukset hyrëse monetare të aktiveve të tjera ose grupeve të tjerë të aktiveve. Identifikimi i një njësie gjeneruese të mjeteve monetare të aktivitetit kërkon gjykim. Nëse shuma e rikuperueshme nuk mund të përcaktohet për një aktiv individual një njësi ekonomike identifikon grupin më të vogël të aktiveve që krijon flukse hyrëse monetare shumë të pavarura.

**Shembull**

Një shoqëri autobuzash ofron shërbimin sipas kontratës për një bashki që kërkon një shërbim minimum në secilën prej pesë rrugëve të veçanta. Aktivet që përdoren për secilën rrugë dhe flukset monetare nga secila rrugë mund të identifikohen veçmas. Një nga rrugët rezultojnë me një humbje të madhe.

*Meqë njësi ekonomike nuk ka mundësi të shkurtojë anë nga rrugët (linjat) e autobuzit, niveli më i ulët i identifikueshëm i flukseve hyrëse monetare që janë shumë të pavarura nga flukset hyrëse monetare të aktiveve të tjera ose grupeve të tjera të aktiveve, është fluksi hyrës monetar i krijuar nga pesë rrugët (linjat) së bashku. Njësi gjeneruese e mjeteve monetare për secilën prej rrugëve (linjave) është shoqëria e autobuzave si një e tërë.*

- 69 Flukset hyrëse monetare janë flukse hyrëse në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare të marra nga palë jashtë njësisë ekonomike. Në identifikimin nëse flukset hyrëse monetare nga një aktiv (ose grupe të aktiveve) janë shumë të pavarura nga flukset hyrëse monetare nga aktivet e tjera (ose grupe të aktiveve), një njësi ekonomike merr në konsideratë faktorë të ndryshëm që përfshijnë mënyrën sesi drejtimi monitoron veprimtarinë e njësisë ekonomike (si p.sh. sipas linjave të prodhimit, bizneseve, pozicioneve individuale, zonave krahinore ose rajonale) ose sesi drejtimi merr vendimet rreth përdorimit ose nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve të njësisë ekonomike ose veprimtarive. Shembulli Ilustrues 1 jep shembuj të identifikimit të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare.

- 70 **Nëse ekziston një treg aktiv për produktin e prodhuar nga një aktiv ose grup aktivesh, ky aktiv ose grup aktivesh duhet të identifikohet si një njësi gjeneruese e mjeteve monetare edhe nëse një pjesë ose i gjithë produkti përdoret brenda njësisë. Nëse flukset hyrëse monetare të krijuara nga një aktiv ose njësi gjeneruese e mjeteve monetare ndikohen nga vendosja e çmimeve të brendshme, një njësi ekonomike duhet të përdorë vlerësimin më të mirë të drejtimit për çmimet e ardhshme që mund të arrihen në një transaksion të pavarur:**

- (a) **flukset hyrëse të ardhshme monetare të përdorura për të përcaktuar vlerën në përdorim të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare të aktivitetit; dhe**
- (b) **flukset dalëse të ardhshme monetare të përdorura për të përcaktuar vlerën në përdorim të çdo aktivi ose njësie gjeneruese të mjeteve monetare tjetër, të cilët ndikohen nga vendosja e çmimeve të brendshme.**

- 71 Edhe nëse një pjesë ose i gjithë produkti i prodhuar nga një aktiv ose grup aktivesh përdoret nga njësitë e tjera të njësisë ekonomike (për shembull, si produkte në një fazë ndërmjetëse të një procesi prodhimi), ky aktiv ose grup aktivesh formon një njësi të veçantë gjeneruese të mjeteve monetare nëse njësi ekonomike mund të shesë produktin në një treg aktiv. Kjo sepse aktiviteti ose grupi i aktiveve mund të krijojë flukse hyrëse monetare të cilat do të jenë shumë të pavarura nga flukset hyrëse monetare të aktiveve të tjera ose grupve të aktiveve. Gjatë përdorimit të informacionit të mbështetur në buxhetet/parashikimet financiare që lidhen me një njësi të tillë gjeneruese të mjeteve monetare, ose të çdo aktivi tjetër ose njësie tjetër gjeneruese të mjeteve monetare të ndikuar nga vendosja e çmimeve të brendshme, një njësi ekonomike rregullon këtë informacion nëse vendosja e çmimeve të brendshme nuk pasqyron vlerësimin më të mirë të drejtimit mbi çmimet e ardhshme që do të arrihen në transaksionet e pavarura.

- 72 **Njësitë gjeneruese të mjeteve monetare duhet të identifikohen në mënyrë që qëndrueshme nga periudha në periudhë për të njëjtin aktiv ose tip të aktiveve, me përjashtim të rastit kur justifikohet ndryshimi.**
- 73 Nëse një njësi ekonomike përcakton se një aktiv i përket një njësie gjeneruese të mjeteve monetare të ndryshme nga ajo e periudhës së mëparëshme, ose se ka ndryshuar tipi i aktiveve të mbledhura (bashkuara) në njësinë gjeneruese të mjeteve monetare të aktivitetit, paragrafi 130 kërkon dhënie informacionesh shpjeguese rreth njësisë gjeneruese të mjeteve monetare nëse njihet ose rrimerret një humbje nga çvlerësimi për njësinë gjeneruese të mjeteve monetare.

## **Shuma e rikuperueshme dhe vlera kontabël e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare**

- 74 Shuma e rikuperueshme e një njësie gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja mes vlerës së drejtë të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare minus kostot e shitjes dhe vlerës së saj në përdorim. Për nevoja të përcaktimit të shumës së rikuperueshme të një njësie gjeneruese të mjeteve monetare, çdo citim në paragrafët 19–57 për ‘një aktiv’ lexohet si citim për ‘një njësi gjeneruese të mjeteve monetare’.
- 75 **Vlera kontabël neto e një njësie gjeneruese të mjeteve monetare duhet të përcaktohet mbi baza të qëndrueshme më mënyrën sesi përcaktohet shuma e realizueshme e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare.**
- 76 Vlera kontabël neto e një njësie gjeneruese të mjeteve monetare:
- përfshin vlerën kontabël neto të vetëm atyre aktiveve që mund të përcaktohen drejtpërdrejt ose të shpërndahen mbi baza të arsyeshme dhe të qëndrueshme, si të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare dhe do të krijojnë flukset hyrëse monetare të ardhshme të përdorura në përcaktimin e vlerës në përdorim të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare; dhe
  - nuk përfshin vlerën kontabël neto të ndonjë pasivi të njohur me përjashtim të rastit kur shuma e rikuperueshme e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare nuk mund të përcaktohet pa marrë në konsideratë këtë pasiv.

Kjo sepse vlera e drejtë minus kostot e shitjes dhe vlera në përdorim e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare përcaktohen duke përjashtuar flukset monetare që lidhen me aktivet të cilat nuk janë pjesë e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare dhe pasivet që janë njohur (shih paragrafët 28 dhe 43).

- 77 Nëse aktivet grupohen për të vlerësuar rikuperimin prej tyre, është e rëndësishme që të përfshihen në njësinë gjeneruese të mjeteve monetare të gjitha aktivet që krijojnë ose që janë përdorur për të krijuar prurjen përkatëse të flukseve hyrëse monetare. Për ndryshe njësia ekonomike mund të duket plotësisht e rikuperueshme kur në fakt ka ndodhur një humbje nga çvlerësimi. Në disa raste, megjithëse disa aktive kontribuojnë në flukset e ardhshme të vlerësuar monetare të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare ato nuk mund të shpërndahen mbi baza të arsyeshme dhe të qëndrueshme tek njësia gjeneruese të mjeteve monetare. Ky mund të jetë rasti i emrit të mirë ose aktiveve të shoqërisë të tillë si aktivet e zyrave qëndrore. Paragrafët 80–103 shpjegojnë sesi do të trajtohen këto aktive gjatë testimit të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare për çvlerësim.
- 78 Për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme të një njësie gjeneruese të mjeteve monetare mund të jetë e nevojshme të merren në konsideratë disa pasive të njohura. Kjo mund të ndodhë nëse nxjerra nga përdorimi e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare do të kërkojë që blerësi të marrë përsipër një pasiv. Në këtë rast vlera e drejtë minus kostot e shitjes (ose fluksi i vlerësuar monetar nga nxjerrja nga përdorimi më e fundit) e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është çmimi i vlerësuar i shitjes për aktivet e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare dhe pasivit së bashku, minus kostot e nxjerrjes nga përdorimi. Për të kryer një krahasim të kuptueshëm mes vlerës kontabël neto të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare dhe shumës së rikuperueshme prej saj, vlera kontabël neto e pasivit zbritet si në përcaktimin e vlerës në përdorim ashtu dhe në përcaktimin e vlerës kontabël neto të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare.

### **Shembull**

Një shoqëri shfrytëzon një minierë në një vend në të cilin legjislacioni kërkon që pronari duhet të sistemojë territorin në përfundim të aktivitetit të tij shfrytëzues në minierë. Kosto e këtij sistemimi përfshin rivendosjen e sipërfaqes së tokës, e cila duhet të hiqet para fillimit të veprimtarisë shfrytëzuese të minierës. Sapo u hoq sipërfaqja e tokës, u njoh një provizion për kostot e rivendosjes të saj. Shuma në fjalë u njoh si pjesë e kostos së minierës dhe amortizohet përgjatë jetës së dobishme të minierës. Vlera kontabël neto e provizionit për shpenzimet e sistemimit të sipërfaqes së tokës është NJM500,<sup>a</sup> e barabartë me vlerën aktuale të kostove të sistemimit.

Njësia ekonomike po teston minierën për çvlerësim. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare për minierën është vetë ajo si një e tërë. Njësia ekonomike ka marrë disa oferta blerjeje për minierën me një çmim rreth NJM800.

**Shembull**

Ky çmim pasqyron faktin se blerësi do të marrë përsipër të risistemojë sipërfaqen e tokës. Kostot e nxjerrjes nga përdorimi të minierës janë të papërfillshme. Vlera në përdorim e minierës është rreth NJM 1,200, pa kostot e sistemimit. Vlera kontabël neto e minierës është NJM 1,000.

*Vlera e drejtë e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare minus kostot e shitjes është NJM 800. Kjo shumë merr në konsideratë kostot e sistemimit të cilat janë vlerësuar tashmë. Për pasojë vlera në përdorim për njësinë gjeneruese të mjeteve monetare përcaktohet pas marrjes në konsideratë të kostove të sistemimit dhe vlerësohet të jetë NJM 700 (NJM 1,200 minus NJM 500). Vlera kontabël neto e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është NJM 500, që është dhe vlera kontabël neto e minierës (NJM 1,000) minus vlerën kontabël neto të provizionit për kostot për sistemimin (NJ 500). Prandaj shuma e rikuperueshme e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën kontabël neto të tij.*

a Në këtë Standard, shumat monetare përcaktohen në 'njësi monetare (NJM)'.

- 79 Për thjeshtësi, shuma e realizueshme e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare ndonjëherë përcaktohet pas marrjes në konsideratë të aktiveve që nuk janë pjesë e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare (për shembull, llogaritë e arkëtueshme ose aktive të tjera financiare) ose pasivet që janë njohur (për shembull llogaritë e pagueshme, pensionet dhe provizione të tjera). Në të tilla raste vlera kontabël neto e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare rritet me vlerën kontabël neto të këtyre aktiveve dhe pakësohet me vlerën kontabël neto të këtyre pasiveve.

**Emri i mirë***Shpërndarja e emrit të mirë sipas njësive gjeneruese të mjeteve monetare*

- 80 **Për qëllimin e testimit për zhvlerësim, emri i mirë i blerë në një kombinim biznesi, që nga data e blerjes, duhet t'u shpërndahet secilës prej njësive gjeneruese të mjeteve monetare, apo të grupeve të njësive gjeneruese të mjeteve monetare të blerësit, të cilat priten të përfitojnë nga sinergjitë e kombinimit të biznesit, pavarësisht nëse këtyre njësive apo grupeve të njësive u janë caktuar aktive apo pasive të tjera të njësive ekonomike të blerë. Çdo njësi ose grup njësish gjeneruese të mjeteve monetare, të cilave u shpërndahet emri i mirë, duhet të:**
- (a) **përfaqësojë nivelin më të ulët brenda njësive ekonomike në të cilin emri i mirë monitorohet për qëllime të drejtimit të brendshëm; dhe**
  - (b) **nuk duhet të jetë më e madhe se një segment shfrytëzimi i përcaktuar në përputhje me SNRF 8 Segmentet e shfrytëzimit.**
- 81 Emri i mirë i njohur në një kombinim biznesi është një aktiv që përfaqëson përfitimet ekonomike të ardhshme që rrjedhin nga aktivet e tjera të blera në një kombinim biznesi që nuk janë të identifikueshme individualisht dhe të njohura veçmas. Emri i mirë nuk krijon flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivet apo grupet e aktiveve të tjera dhe shpesh kontribuon në flukset monetare të disa njësive gjeneruese të mjeteve monetare njëherësh. Ndonjëherë, emri i mirë nuk mund t'u shpërndahet njësive individuale gjeneruese të mjeteve monetare mbi një bazë joarbitrare, por vetëm grupeve të njësive gjeneruese të mjeteve monetare. Për rrjedhojë, niveli më i ulët brenda njësive ekonomike në të cilin monitorohet emri i mirë për qëllime të drejtimit të brendshëm përfshin ndonjëherë një numër njësish gjeneruese të mjeteve monetare me të cilat lidhet emri i mirë, por të cilave nuk mund t'u shpërndahet. Në paragrafët 83–99 dhe Shtojcën C, ku thuhet që një njësi gjeneruese e mjeteve monetare i është shpërndarë emri i mirë duhet të kuptohet edhe si një grup njësish gjeneruese të mjeteve monetare që i është shpërndarë emri i mirë.
- 82 Zbatimi i kërkesave të paragrafit 80 çon në testimin për zhvlerësim të emrit të mirë në një nivel i cili pasqyron mënyrën se si i menaxhon operacionet e veta një njësi ekonomike dhe me të cilën do të shoqërohej natyrshëm emri i mirë. Për rrjedhojë, zhvillimi i sistemeve raportuese shtesë zakonisht nuk është i nevojshëm.
- 83 Një njësi gjeneruese e mjeteve monetare, të cilës i është shpërndarë emri i mirë për qëllimin e testimit për zhvlerësim, mund të mos përputhet me nivelin në të cilin emri i mirë është shpërndarë në përputhje me SNK 21 *Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit të monedhave të huaja* për qëllimin e matjes së fitimeve dhe humbjeve neto në monedhë të huaj. Për shembull, nëse sipas SNK 21, një njësi ekonomike kërkohet ta shpërndajë emrin e mirë në nivele relativisht të ulëta për qëllimin e matjes së fitimeve dhe humbjeve neto në monedhë të huaj, nuk kërkohet që emri i mirë të testohet për zhvlerësim në të njëjtin nivel nëse ajo nuk e monitoron emrin e mirë në atë nivel për qëllime të drejtimit të brendshëm.

84 Nëse shpërndarja fillestare e emrit të mirë të blerë në një kombinim biznesi nuk mund të kryhet përpara mbylljes së periudhës vjetore në të cilin ndodh kombinimi i biznesit, atëherë kjo shpërndarje duhet të kryhet para fundit të periudhës së parë vjetore që fillon pas datës së blerjes.

85 Në përputhje me SNRF 3 *Kombinimet e bizneseve*, nëse kontabilizimi fillestar i një kombinimi biznesi mund të bëhet vetëm përkohësisht deri në fund të periudhës në të cilin ndodh kombinimi i biznesit, blerësi:

- (a) e kontabilizon kombinimin duke përdorur këto vlera paraprake; dhe
- (b) njeh të gjitha rregullimet e këtyre vlerave paraprake që bëhen si rezultat i përfundimit të kontabilizimit fillestar brenda periudhës së matjes, që nuk duhet të kalojë 12 muaj nga data e blerjes.

Në disa rrethana, gjithashtu mund të mos jetë e mundur të përfundojë shpërndarja fillestare e emrit të mirë të njohur në kombinim para mbylljes së periudhës vjetore në të cilin ka ndodhur kombinimi. Në një rast të tillë, njësia ekonomike jep informacione shpjeguese siç kërkohet në paragrafin 133.

86 Nëse emri i mirë i është shpërndarë një njësie gjeneruese të mjeteve monetare dhe njësia ekonomike nxjerr jashtë përdorimit një operacion brenda kësaj njësie gjeneruese të mjeteve monetare, atëherë emri i mirë që lidhet me këtë operacion të hequr duhet:

- (a) të përfshihet në vlerën kontabël neto të operacionit gjatë përcaktimit të fitimit ose humbjes neto nga nxjerrja jashtë përdorimit; dhe
- (b) të matet në bazë të vlerave relative të operacionit të nxjerrë jashtë përdorimit dhe të pjesës së mbetur të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare, nëse njësia ekonomike nuk mund të tregojë se emrin e mirë të lidhur me operacionin e nxjerrë jashtë përdorimit e pasqyron më mirë ndonjë metodë tjetër.

Shembull
<p>Një njësi ekonomike shet për 100 NJM një operacion që ishte pjesë e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i është shpërndarë emri i mirë. Emri i mirë që i është shpërndarë njësisë nuk mund të identifikohet apo të shoqërohet me një grup aktivesh në një nivel më të ulët se njësia, pa e bërë një gjë të tillë në mënyrë arbitrare. Shuma e rikuperueshme e pjesës së mbetur të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është 300 NJM.</p> <p><i>Meqë emri i mirë, që i është shpërndarë njësisë gjeneruese të mjeteve monetare, nuk mund të identifikohet ose të shoqërohet në mënyrë joarbitrare me një grup aktivesh në një nivel më të ulët se ai i njësisë, emri i mirë që i përket operacionit të shitur matet në bazë të vlerave relative dhe pjesës së mbetur të njësisë. Pra, 25% e emrit të mirë të shpërndarë në njësinë gjeneruese të mjeteve monetare përfshihet në vlerën kontabël neto të operacionit të shitur.</i></p>

87 Nëse një njësi ekonomike riorganizon strukturën e saj të raportimit në mënyrë të tillë që ndryshon përbërjen e një ose më shumë njësive gjeneruese të mjeteve monetare të cilave u është shpërndarë emri i mirë, atëherë emri i mirë duhet të rishpërndahet tek njësitë e ndryshuara. Kjo rishpërndarje duhet të kryhet duke përdorur metodën e vlerave relative të ngjashme me atë të përdorur kur një njësi ekonomike nxjerr jashtë përdorimit një operacion që ka qenë brenda një njësie gjeneruese të mjeteve monetare, përveçse kur njësia ekonomike mund të tregojë se ndonjë metodë tjetër pasqyron më mirë emrin e mirë që u shpërndahet njësive të riorganizuara.

Shembull
<p>Njësisë gjeneruese të mjeteve monetare A i është shpërndarë më parë emër i mirë. Emri i mirë që i është shpërndarë A-së nuk mund të identifikohet apo të shoqërohet me një grup aktivesh në një nivel më të ulët se A-ja, pa e bërë këtë arbitrarisht. A-ja duhet të ndahet dhe të integrohet në tre njësi gjeneruese të mjeteve monetare, B, C dhe D.</p> <p><i>Ngaqë emri i mirë që i është shpërndarë A-së nuk mund të identifikohet apo shoqërohet në mënyrë joarbitrare me një grup aktivesh në një nivel më të ulët se A-ja, emri i mirë u shpërndahet njësive B, C dhe D në bazë të vlerave relative të tri pjesëve të A-së përpara se këto pjesë të integrohen në B, C dhe D.</i></p>

#### *Testimi për zhvlerësim i njësive gjeneruese të mjeteve monetare me emër të mirë*

88 Kur emri i mirë ka lidhje me një njësi gjeneruese të mjeteve monetare, siç përshkruhet në paragrafin 81, por nuk i është shpërndarë kësaj njësie, kjo njësi duhet të testohet për zhvlerësim, sa herë që ka një tregues se njësia gjeneruese e mjeteve monetare mund të jetë e zhvlerësuar, duke krahasuar vlerën

**kontabël neto të saj, përjashtuar emrin e mirë, me shumën e rikuperueshme të saj. Çdo humbje nga zhvlerësimi duhet të njihet në përputhje me paragrafin 104.**

- 89 Nëse një njësi gjeneruese e mjeteve monetare e përshkruar në paragrafin 88 përfshin në vlerën kontabël neto të saj një aktiv jomaterial me jetë të dobishme të papërcaktuar ose që nuk është ende i disponueshëm për përdorim dhe nëse ky aktiv mund të testohet për zhvlerësim vetëm si pjesë e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare, paragrafi 10 kërkon që edhe njësi gjeneruese e mjeteve monetare të testohet për zhvlerësim çdo vit.
- 90 **Një njësi gjeneruese e mjeteve monetare, të cilës i është shpërndarë emër i mirë, duhet të testohet për zhvlerësim çdo vit dhe sa herë që ka një shenjë se njësi mund të jetë e zhvlerësuar, duke krahasuar vlerën kontabël neto të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare, përfshirë emrin e mirë, me shumën e rikuperueshme të saj. Nëse shumën e rikuperueshme të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhe se vlera kontabël neto e saj, njësi gjeneruese e mjeteve monetare dhe emri i mirë që i është shpërndarë kësaj njësie duhet të konsiderohen si jo të zhvlerësuar. Nëse vlera kontabël neto e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhe se shumën e rikuperueshme të saj, njësi ekonomike duhet të njohë humbje nga zhvlerësimi në përputhje me paragrafin 104.**
- 91-95 [Hequr]

#### *Koha e testeve të zhvlerësimit*

- 96 **Testi vjetor i zhvlerësimit për një njësi gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i është shpërndarë emri i mirë mund të kryhet në çdo kohë gjatë një periudhe vjetore, me kusht që testimi të kryhet në të njëjtën kohë çdo vit. Njësi gjeneruese të mjeteve monetare të ndryshme mund të testohen për zhvlerësim në kohë të ndryshme. Megjithatë, nëse një pjesë ose i gjithë emri i mirë i shpërndarë një njësie gjeneruese të mjeteve monetare është blerë në një kombinim biznesi gjatë periudhës vjetore aktuale, kjo njësi do të testohet për zhvlerësim përpara fundit të periudhës aktuale.**
- 97 Nëse aktivet që përbëjnë njësinë gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i është shpërndarë emri i mirë testohen për zhvlerësim në të njëjtën kohë me njësinë që e ka emrin e mirë, ato duhet të testohen për zhvlerësim përpara njësisë gjeneruese të mjeteve monetare që ka emrin e mirë. Po kështu, nëse njësitë gjeneruese të mjeteve monetare që përbëjnë një grup njësisish gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i është shpërndarë emri i mirë testohen për zhvlerësim në të njëjtën kohë me grupin e njësive që e ka emrin e mirë, grupet individuale duhet të testohen për zhvlerësim përpara grupit të njësive gjeneruese të mjeteve monetare që ka emrin e mirë.
- 98 Në kohën e testimit për zhvlerësim të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i është shpërndarë emri i mirë, mund të ketë një tregues për zhvlerësim të një aktivi të njësive që ka emrin e mirë. Në këto rrethana, njësi ekonomike në fillim bën një testim për zhvlerësim të aktivit dhe një humbje nga zhvlerësimi, nëse ka, për këtë aktiv përpara se ta testojë për zhvlerësim njësinë gjeneruese të mjeteve monetare që ka emrin e mirë. Po kështu, mund të ketë një tregues të një zhvlerësimi të një njësie gjeneruese të mjeteve monetare brenda një grupi njësisish gjeneruese të mjeteve monetare që ka emrin e mirë. Në këto rrethana, njësi ekonomike bën në fillim një testim për zhvlerësim të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare dhe një humbje nga zhvlerësimi për këtë njësi përpara se ta testojë për zhvlerësim grupin e njësive të mjeteve monetare të cilit i është shpërndarë emri i mirë.
- 99 **Llogaritja e hollësishme më e fundit e bërë në një periudhë të mëparshme për vlerën e rikuperueshme të një njësie gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i është shpërndarë emri i mirë mund të përdoret në testimin e zhvlerësimit për këtë njësi në periudhën aktuale, me kusht që të jenë plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara:**
- aktivet dhe pasivet që përbëjnë njësinë gjeneruese të mjeteve monetare të mos kenë ndryshuar ndjeshëm qysh prej llogaritjes më të fundit të shumës së rikuperueshme;
  - llogaritja më e fundit e shumës së rikuperueshme të ketë nxjerrë një vlerë e cila është më e madhe se vlera kontabël neto e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare me një marzh të rëndësishëm; dhe
  - në bazë të një analize të ngjarjeve që kanë ndodhur dhe të rrethanave që kanë ndryshuar qysh prej llogaritjes më të fundit të shumës së rikuperueshme, do të kishte pak mundësi që shumën e rikuperueshme aktuale të ishte më e vogël se vlera kontabël neto aktuale e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare.

#### **Aktivitet kolektive**

- 100 Aktivitet kolektive të shoqërisë përfshijnë aktive të grupuara ose individuale si për shembull ndërtesa e selisë qendrore ose një departament i njësisë ekonomike, pajisje elektronike ose një qendër kërkimore. Struktura e një njësie ekonomike është faktor vendimtar në vlerësimin nëse një aktiv e përmbush apo jo përkufizimin e këtij Standardi për aktivitet kolektive të shoqërisë për një njësi të veçantë gjeneruese të mjeteve monetare.

Karakteristikat dalluese të aktiveve kolektive të shoqërisë janë se ato nuk krijojnë flukse monetare hyrëse të pavarura nga aktivet e tjera ose grupet e tjera të aktiveve dhe se vlera kontabël neto e tyre nuk mund t'i ngarkohet drejtpërdrejt në njësi gjeneruese të mjeteve monetare që po shqyrtohet.

- 101 Meqënëse aktivet kolektive të shoqërisë nuk krijojnë flukse monetare hyrëse të veçanta, shumata e rikuperueshme e një aktivi individual të shoqërisë nuk mund të përcaktohet nëse drejtimi nuk ka marrë vendim për ta nxjerrë jashtë përdorimit këtë aktiv. Për pasojë, nëse ka një tregues se mund të jetë i zhvlerësuar një aktiv kolektiv i shoqërisë, përcaktohet shumata e rikuperueshme për njësinë gjeneruese të mjeteve monetare ose grupin e njësive gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i përket aktivi kolektiv, dhe kjo shumë e rikuperueshme krahasohet me vlerën kontabël neto të kësaj njësie gjeneruese të mjeteve monetare ose të grupit të njësive gjeneruese të mjeteve monetare. Çdo humbje nga zhvlerësimi njihet në përputhje me paragrafin 104.
- 102 Gjatë testimit të një njësie gjeneruese të mjeteve monetare për zhvlerësim, një njësi ekonomike duhet t'i identifikojë të gjithë aktivet kolektive të cilët kanë lidhje me njësinë gjeneruese të mjeteve monetare që po shqyrtohet. Nëse një pjesë e vlerës kontabël neto të aktivit kolektiv:
- (a) mund t'i shpërndahet kësaj njësie gjeneruese të mjeteve monetare mbi një bazë të arsyeshme dhe të njëtrajtshme, njësi ekonomike duhet të krahasojë vlerën kontabël neto të njësive gjeneruese të mjeteve monetare, përfshirë edhe pjesën e vlerës kontabël neto të aktivit kolektiv që i është shpërndarë, me shumën e rikuperueshme të saj. Çdo humbje nga zhvlerësimi duhet të njihet në përputhje me paragrafin 104.
  - (b) nuk mund t'i shpërndahet kësaj njësie gjeneruese të mjeteve monetare mbi një bazë të arsyeshme dhe të njëtrajtshme, njësi ekonomike:
    - (i) duhet të krahasojë vlerën kontabël neto të njësive gjeneruese të mjeteve monetare, përjashtuar aktivin kolektiv, me shumën e rikuperueshme të saj dhe të njohë humbje nga zhvlerësimi, nëse ka, në përputhje me paragrafin 104;
    - (ii) duhet të identifikojë grupin më të vogël të njësive gjeneruese të mjeteve monetare që përfshin njësinë gjeneruese të mjeteve monetare që po shqyrtohet dhe të cilit mund t'i shpërndahet një pjesë e vlerës kontabël neto të aktivit kolektiv të shoqërisë mbi një bazë të arsyeshme dhe të njëtrajtshme; dhe
    - (iii) duhet ta krahasojë vlerën kontabël neto të këtij grupi të njësive gjeneruese të mjeteve monetare, përfshirë edhe pjesën e vlerës kontabël neto të aktivit kolektiv që i është shpërndarë këtij grupi të njësive, me shumën e rikuperueshme të grupit të njësive gjeneruese të mjeteve monetare. Çdo humbje nga zhvlerësimi duhet të njihet në përputhje me paragrafin 104.
- 103 Shembulli sqarues 8 shpjegon zbatimin e këtyre kërkesave për aktivet kolektive.

## Humbja nga zhvlerësimi për një njësi gjeneruese të mjeteve monetare

- 104 Një humbje nga zhvlerësimi për një njësi gjeneruese të mjeteve monetare (grupi më i vogël i njësive gjeneruese të mjeteve monetare të cilit i është shpërndarë emri i mirë ose një aktiv kolektiv) duhet të njihet atëherë dhe vetëm atëherë kur shumata e rikuperueshme e kësaj njësie (grupi njësish) gjeneruese të mjeteve monetare është më e vogël se vlera kontabël neto e kësaj njësie (grupi njësish) gjeneruese të mjeteve monetare. Humbja nga zhvlerësimi shpërndahet duke zvogëluar vlerën kontabël neto të aktiveve të njësive (grupit të njësive) gjeneruese të mjeteve monetare sipas rendit të mëposhtëm:
- (a) së pari, për të zvogëluar vlerën kontabël neto të emrit të mirë që i është shpërndarë njësive (grupit të njësive) gjeneruese të mjeteve monetare; dhe
  - (b) pastaj, për aktivet e tjera të njësive (grupit të njësive) gjeneruese të mjeteve monetare në përpjesëtim me vlerën kontabël neto të çdo aktivi në njësi (grupin e njësive) gjeneruese të mjeteve monetare.
- Këto zvogëlime të vlerave kontabël neto duhet të trajtohen si humbje nga zhvlerësimi mbi aktivet individuale dhe të njihen në përputhje me paragrafin 60.
- 105 Gjatë shpërndarjes së një humbjeje nga zhvlerësimi në përputhje me paragrafin 104, një njësi ekonomike nuk duhet ta zvogëlojë vlerën kontabël neto të një aktivi më poshtë se më i lartë prej niveleve të mëposhtme:
- (a) vlera e drejtë minus kostot për shitje (nëse është e përcaktueshme);
  - (b) vlera në përdorim (nëse është e përcaktueshme); dhe
  - (c) zero.



**Shuma e humbjes nga zhvlerësimi e cila do t'i shpërndahej aktivitet në kushte të tjera duhet t'u shpërndahet në mënyrë përpjesëtimore aktiveve të tjera të njësisë (grupit të njësive) gjeneruese të mjeteve monetare.**

- 106 Nëse është e përcaktueshme të vlerësohet shuma e rikuperueshme e çdo aktivi individual të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare, ky Standard kërkon që të bëhet një shpërndarje arbitrare e humbjes nga zhvlerësimi midis aktiveve të kësaj njësie, me përjashtim të emrit të mirë, sepse të gjitha aktivitet e një njësie gjeneruese të mjeteve monetare funksionojnë së bashku.
- 107 Nëse nuk mund të përcaktohet shuma e rikuperueshme e një aktivi individual (shih paragrafin 67):
- njihet një humbje nga zhvlerësimi për aktivin nëse vlera kontabël neto e tij është më e madhe se vlera e drejtë minus kostot për shitje ose rezultati i procedurës së shpërndarjes të përshkruar në paragrafët 104 dhe 105, cilado qoftë më e larta; dhe
  - nuk njihet asnjë humbje nga zhvlerësimi për aktivin nëse nuk është zhvlerësuar njësia gjeneruese e mjeteve monetare e cila lidhet me të. Kjo vlen edhe atëherë kur vlera e drejtë minus kostot për shitje e aktivitet është më e vogël se vlera kontabël neto e tij.

<b>Shembull</b>	
<p>Një makineri ka pësuar dëmtim fizik por funksionon ende, edhe pse jo aq mirë sa përpara se të dëmtohej. Vlera e drejtë minus kostot për shitje e makinerisë është më e vogël se vlera kontabël neto e saj. Makineria nuk krijon flukse monetare hyrëse të pavarura. Grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që e përfshin makinerinë dhe krijon flukse monetare hyrëse, të cilat janë kryesisht të pavarura nga flukset monetare hyrëse nga aktivitet e tjera ose grupet e tjera të aktiveve, është linja e prodhimit të cilës i përket makineria. Shuma e rikuperueshme e linjës së prodhimit tregon se linja e prodhimit, e marrë si e tërë, nuk është e zhvlerësuar.</p> <p>Supozimi 1: buxhetet/parashikimet e aprovuara nga drejtimi nuk pasqyrojnë asnjë angazhim të drejtimit për ta zëvendësuar makinerinë.</p> <p><i>Vetë shuma e rikuperueshme e makinerisë nuk mund të vlerësohet, sepse vlera në përdorim e makinerisë:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li><i>mund të jetë e ndryshme nga vlera e drejtë minus kostot për shitje e saj; dhe</i></li> <li><i>mund të përcaktohet vetëm për njësinë gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i përket makineria (linja e prodhimit).</i></li> </ol> <p><i>Linja e prodhimit nuk është e zhvlerësuar. Për rrjedhojë, për makinerinë nuk njihet asnjë humbje nga zhvlerësimi. Megjithatë, njësia ekonomike mund të ketë nevojë të rivlerësojë periudhën e amortizimit ose metodën e amortizimit për makinerinë. Ndoshta, kërkohet një periudhë më e shkurtër amortizimi ose një metodë amortizimi më e shpejtë për të pasqyruar jetën e pritshme të dobishme të mbetur të makinerisë ose modelin sipas të cilit pritet të konsumohen nga njësia ekonomike përfitimet ekonomike.</i></p> <p>Supozimi 2: buxhetet/parashikimet e aprovuara nga drejtimi pasqyrojnë një angazhim të drejtimit për ta zëvendësuar makinerinë dhe për ta shitur atë në të ardhmen e afërt. Flukset monetare nga përdorimi i vazhduar i makinerisë deri në nxjerrjen jashtë përdorimit të saj vlerësohen se janë të papërfillshme.</p> <p><i>Vlera në përdorim e makinerisë mund të vlerësohet si e afërt me vlerën e drejtë minus kostot për shitjen e saj. Rrjedhimisht, mund të përcaktohet vlera kontabël neto e makinerisë dhe nuk merret në konsideratë njësia gjeneruese e mjeteve monetare të cilës i përket makineria (linja e prodhimit). Meqënëse vlera e drejtë minus kostot për shitje të makinerisë është më e vogël se vlera kontabël neto e saj, njihet një humbje nga zhvlerësimi për makinerinë.</i></p>	

- 108 Pasi janë zbatuar kërkesat e paragrafëve 104 dhe 105, njihet një detyrim në pasive për çdo shumë të mbetur të një humbjeje nga zhvlerësimi për një njësi gjeneruese të mjeteve monetare atëherë dhe vetëm atëherë kur kjo kërkohet nga një Standard tjetër.

## Anullimi i një humbjeje nga zhvlerësimi

- 109 Paragrafët 110-116 paraqesin kërkesat për anulimin e një humbjeje nga zhvlerësimi të njohur në periudhat e mëparshme për një aktiv ose një njësi gjeneruese të mjeteve monetare. Këto kërkesa përdorin termin “një aktiv”, por zbatohen njësoj si për një aktiv individual, ashtu edhe për një njësi gjeneruese të mjeteve monetare. Në paragrafët 117-121 paraqiten disa kërkesa të tjera shtesë për një aktiv individual, ndërsa kërkesa të tilla shtesë për një njësi gjeneruese të mjeteve monetare paraqiten në paragrafët 122 dhe 123, dhe për emrin e mirë në paragrafët 124 dhe 125.
- 110 Një njësi ekonomike duhet të vlerësojë në çdo datë raportimi nëse ka apo jo ndonjë tregues se mund të mos ekzistojë më ose mund të jetë zvogëluar një humbje nga zhvlerësimi e njohur në periudhat e mëparshme për një aktiv, me përjashtim të emrit të mirë. Nëse ka tregues të tillë, atëherë njësia ekonomike duhet të vlerësojë shumën e rikuperueshme të këtij aktivi.
- 111 Gjatë vlerësimit nëse ka apo jo tregues se mund të mos ekzistojë më ose mund të jetë zvogëluar një humbje nga zhvlerësimi e njohur në periudhat e mëparshme për një aktiv, me përjashtim të emrit të mirë, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë, minimumi, treguesit e mëposhtëm:

Burimet e jashtme të informacionit

- (a) vlera e tregut e aktivit është rritur ndjeshëm gjatë periudhës.
- (b) gjatë periudhës kanë ndodhur ose do të ndodhin në të ardhmen e afërt ndryshime të ndjeshme me një efekt të favorshëm mbi njësinë ekonomike, në fushën teknologjike, në treg, në mjedisin teknik apo atë ligjor, në të cilin ushtron aktivitetet njësia ekonomike ose në tregun të cilit i përket një aktiv.
- (c) normat e interesit në treg ose normat e tjera të kthimit mbi investimet në treg janë ulur gjatë periudhës, dhe këto ulje ka mundësi të prekin normën e skontimit që përdoret në llogaritjen e vlerës në përdorim të një aktivi dhe ta rrisin materialisht shumën e rikuperueshme të aktivit.

Burimet e brendshme të informacionit

- (d) gjatë periudhës kanë ndodhur ose do të ndodhin në të ardhmen e afërt ndryshime të ndjeshme me një efekt të favorshëm mbi njësinë ekonomike, në shkallën ose mënyrën në të cilën përdoret ose pritet të përdoret një aktiv. Këto ndryshime përfshijnë kostot e kryera gjatë periudhës për përmirësimin ose rritjen e performancës së aktivit ose për ristrukturimin e operacionit të cilit i përket aktivi.
  - (e) nga raportimi i brendshëm ka informacion që tregon se performanca ekonomike e një aktivi është ose do të jetë më e mirë nga sa pritej.
- 112 Treguesit e një zvogëlimi të mundshëm të një humbjeje nga zhvlerësimi, që përmenden në paragrafin 111, pasqyrojnë kryesisht treguesit e një humbjeje të mundshme nga zhvlerësimi që përmenden në paragrafin 12.
- 113 Nëse ka tregues që nuk ekziston më ose mund të jetë zvogëluar një humbje nga zhvlerësimi e njohur për një aktiv, përveç emrit të mirë, kjo mund të tregojë se duhet të shqyrtohet dhe të rregullohet jeta e mbetur e dobishme, metoda e amortizimit ose vlera e mbetur për aktivin, në përputhje me Standardin e zbatueshëm për aktivin, edhe sikur asnjë humbje nga zhvlerësimi të mos anulohet për aktivin.
- 114 Një humbje nga zhvlerësimi e njohur në periudhat e mëparshme për një aktiv, përveç emrit të mirë, duhet të anulohet atëherë dhe vetëm atëherë kur ka patur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme të aktivit qysh prej momentit kur është njohur humbja e fundit nga zhvlerësimi. Nëse është kështu, atëherë vlera kontabël neto e aktivit duhet të rritet në nivelin e shumës së rikuperueshme të tij, me përjashtim të rasteve që përshkruhen në paragrafin 117. Kjo rritje është një anulim i humbjes nga zhvlerësimi.
- 115 Një anulim i një humbjeje nga zhvlerësimi pasqyron një rritje në potencialin e vlerësuar të shërbimit të një aktivi, qoftë nga përdorimi, qoftë nga shitja, qysh prej datës kur njësia ekonomike ka njohur një humbje nga zhvlerësimi për këtë aktiv. Paragrafi 130 kërkon që njësia ekonomike të identifikojë ndryshimin në vlerësimet të cilat shkaktojnë rritjen e potencialit të vlerësuar të shërbimit. Disa shembuj të ndryshimeve në vlerësime janë:
- (a) një ndryshim në bazën e shumës së rikuperueshme (d.m.th. nëse shuma e rikuperueshme bazohet në vlerën e drejtë minus kostot për shitje apo në vlerën në përdorim);
  - (b) një ndryshim në vlerën ose kohën e flukseve monetare të ardhshme të vlerësuara ose në normën e skontimit, nëse shuma e rikuperueshme është bazuar në vlerën në përdorim; ose

- (c) një ndryshim në vlerësimin e përbërësve të vlerës së drejtë minus kostot për shitje, nëse shuma e rikuperueshme është bazuar në vlerën e drejtë minus kostot për shitje.
- 116 Vlera në përdorim e një aktivi mund ta kalojë vlerën kontabël neto të aktivitetit, thjesht ngaqë vlera aktuale e flukseve monetare hyrëse rritet me afrimin e kohës së tyre. Megjithatë, potenciali i shërbimit i aktivitetit nuk është rritur. Rrjedhimisht, një humbje nga zhvlerësimi nuk anulohet thjesht për shkak të kalimit të kohës (ndonjëherë e quajtur edhe si “likuidim” i skontimit), edhe sikur shuma e rikuperueshme të bëhet më e lartë se vlera kontabël neto e tij.

## **Anullimi i një humbjeje nga zhvlerësimi për një aktiv individual**

- 117 **Vlera kontabël neto e rritur e një aktivi, përveç emrit të mirë, që i ngarkohet një anullimi të një humbjeje nga zhvlerësimi nuk duhet të jetë më e madhe se vlera kontabël neto që do të ishte përcaktuar (pas zbritjes së amortizimit) nëse nuk do të ishte njohur asnjë humbje nga zhvlerësimi për aktivin gjatë viteve të mëparshme.**
- 118 Çdo rritje në vlerën kontabël neto të një aktivi, përveç emrit të mirë, mbi vlerën kontabël neto që do të ishte përcaktuar (pas zbritjes së amortizimit), nëse nuk do të ishte njohur asnjë humbje nga zhvlerësimi për aktivin gjatë viteve të mëparshme, përbën rivlerësim. Në kontabilizimin e një rivlerësimi të tillë, një njësi ekonomike përdor Standardin e zbatueshëm për aktivin.
- 119 **Një anullim i një humbjeje nga zhvlerësimi për një aktiv, përveç emrit të mirë, duhet të njihet menjëherë në fitim ose humbje, me përjashtim të rasteve kur aktivi mbahet me vlerën e rivlerësuar në përputhje me një Standard tjetër (për shembull, në përputhje me modelin e rivlerësimit në SNK 16). Çdo anullim i një humbjeje nga zhvlerësimi të një aktivi të rivlerësuar duhet të trajtohet si një rivlerësim në rritje në përputhje me këtë Standard tjetër.**
- 120 Një anullim i një humbjeje nga zhvlerësimi për një aktiv të rivlerësuar njihet në fitimin tjetër të përgjithshëm dhe rritet tepër nga rivlerësimi e këtij aktivi. Megjithatë, për aq sa është njohur më parë në fitim ose në humbje një humbje nga zhvlerësimi për të njëjtin aktiv të rivlerësuar, po aq njihet në fitim ose në humbje një anullim i kësaj humbjeje nga zhvlerësimi.
- 121 **Pas njohjes së një anullimi të një humbjeje nga zhvlerësimi, shuma e amortizimit për aktivin duhet të rregullohet në periudhat e ardhshme për të shpërndarë vlerën kontabël neto të ndryshuar të aktivitetit, minus vlerën e mbetur të tij (nëse ka), mbi një bazë të rregullt gjatë jetës së dobishme të mbetur.**

## **Anullimi i një humbjeje nga zhvlerësimi për një njësi gjeneruese të mjeteve monetare**

- 122 Një anullim i një humbjeje nga zhvlerësimi për një njësi gjeneruese të mjeteve monetare duhet t’u shpërndahet aktiveve të njësisë, me përjashtim të emrit të mirë, në mënyrë proporcionale me vlerat kontabël neto të këtyre aktiveve. Këto rritje të vlerave kontabël neto duhet të trajtohen si anulime të humbjeve nga zhvlerësimi mbi aktivet individuale dhe të njihen në përputhje me paragrafin 119.
- 123 **Gjatë shpërndarjes së një anullimi të një humbjeje nga zhvlerësimi për një njësi gjeneruese të mjeteve monetare në përputhje me paragrafin 122, vlera kontabël neto e një aktivi nuk duhet të rritet mbi njërin prej shumave më të ulëta të mëposhtme:**
- (a) shumën e rikuperueshme të tij (nëse është e përcaktueshme); dhe
  - (b) vlerën kontabël neto e cila do të ishte përcaktuar (pasi zbritet amortizimi), nëse nuk do të ishte njohur asnjë humbje nga zhvlerësimi për aktivin gjatë periudhave të mëparshme. Shuma e anulimit të humbjes nga zhvlerësimi e cila do t’i shpërndahej aktivitetit në kushte të tjera duhet t’u shpërndahej në mënyrë përpjesëtimore aktiveve të tjera të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare, me përjashtim të emrit të mirë.

## **Anullimi i një humbjeje nga zhvlerësimi për emrin e mirë**

- 124 Një humbje nga zhvlerësimi e njohur për emrin e mirë nuk anulohet në një periudhë të mëpasshme.
- 125 SNK 38 *Aktivet afatgjata jo-materiale* e ndalon njohjen e emrit të mirë të krijuar brenda për brenda. Ka mundësi që çdo rritje në shumën e rikuperueshme të emrit të mirë në periudhat që vijojnë njohjen e një humbjeje nga zhvlerësimi për këtë emër të mirë, të jetë një rritje e emrit të mirë të krijuar brenda për brenda njësisë ekonomike, dhe jo një anullim i humbjes nga zhvlerësimi i njohur për emrin e mirë të blerë.

## Dhënia e informacioneve shpjeguese

- 126 Një njësi ekonomike duhet të japë informacionet shpjeguese të mëposhtme për çdo klasë të aktiveve:
- (a) shumën e humbjeve nga zhvlerësimi të njohur si fitim ose humbje gjatë periudhës dhe zërin ose zërat e pasqyrës së të ardhurave të përgjithshme, në të cilën përfshihen këto humbje nga zhvlerësimi.
  - (b) shumën e anulimeve të humbjeve nga zhvlerësimi të njohur si fitim ose humbje gjatë periudhës dhe zërin ose zërat e pasqyrës së të ardhurave të përgjithshme në të cilat anulohen këto humbje nga zhvlerësimi.
  - (c) shumën e humbjeve nga zhvlerësimi mbi aktivet e rivlerësuara të njohur në të ardhurat e tjera të përgjithshme gjatë periudhës.
  - (d) shumën e anulimeve të humbjeve nga zhvlerësimi mbi aktivet e rivlerësuara të njohur në të ardhurat e tjera të përgjithshme gjatë periudhës.
- 127 Një klasë aktivesh është një grupim i aktiveve me karakter të ngjashëm dhe përdorim të ngjashëm në operacionet e njësisë ekonomike.
- 128 Informacioni që kërkohet në paragrafin 126 mund të paraqitet edhe me informacionet e tjera shpjeguese të dhëna për klasën e aktiveve. Për shembull, ky informacion mund të përfshihet në një rakordim të vlerës kontabël neto të zërit aktive afatgjata materiale në fillim dhe në fund të periudhës, sikurse kërkohet nga SNK 16.
- 129 Një njësi ekonomike e cila raporton informacion për segmentet në përputhje me SNRF 8 duhet të japë informacionet shpjeguese të mëposhtme për çdo segment raportues:
- (a) shumën e humbjeve nga zhvlerësimi të njohur në fitim ose humbje dhe në të ardhurat e tjera të përgjithshme gjatë periudhës.
  - (b) shumën e anulimeve të humbjeve nga zhvlerësimi të njohur në fitim ose humbje dhe në të ardhurat e tjera të përgjithshme gjatë periudhës.
- 130 Një njësi ekonomike duhet të japë informacionet shpjeguese të mëposhtme për çdo humbje materiale nga zhvlerësimi të njohur ose të anuluar gjatë periudhës për një aktiv individual, përfshirë edhe emrin e mirë, ose për një njësi gjeneruese të mjeteve monetare:
- (a) ngjarjet dhe rrethanat që kanë çuar në njohjen ose anulimin e humbjes nga zhvlerësimi.
  - (b) shumën e humbjes nga zhvlerësimi të njohur ose të anuluar.
  - (c) për një aktiv individual:
    - (i) natyrën e aktivitetit; dhe
    - (ii) segmentin raportues të cilit i përket aktivi, nëse njësi ekonomike raporton informacion për segmentet në përputhje me SNRF 8.
  - (d) për një njësi gjeneruese të mjeteve monetare:
    - (i) një përshkrim të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare (si për shembull, nëse është apo jo një linjë prodhimi, një impiant, një operacion biznesi, një zonë gjeografike, ose një segment raportues sikurse përkufizohet në SNRF 8);
    - (ii) shumën e humbjes nga zhvlerësimi të njohur ose të anuluar sipas klasës së aktiveve dhe, nëse njësi ekonomike raporton informacion për segmentet në përputhje me SNRF 8, sipas segmenteve raportues; dhe
    - (iii) një përshkrim të mënyrës aktuale dhe asaj të mëparshme të totalizimit të aktiveve dhe arsyet e ndryshimit të mënyrës së identifikimit të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare, nëse ka ndryshuar totalizimi i aktiveve për identifikimin e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare qysh prej vlerësimit të mëparshëm të shumës së rikuperueshme (nëse ka) të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare.
  - (e) nëse shuma e rikuperueshme e aktivitetit (njësisë gjeneruese të mjeteve monetare) është vlera e drejtë minus kostot për shitje apo vlera në përdorim e tij.
  - (f) nëse shuma e rikuperueshme është vlera e drejtë minus kostot për shitje, bazën e përdorur për të përcaktuar vlerën e drejtë minus kostot për shitje (si për shembull nëse vlera e drejtë është përcaktuar duke iu referuar një tregu aktiv).
  - (g) nëse shuma e rikuperueshme është vlera në përdorim, normën ose normat e skontimit të përdorura në vlerësimin aktual dhe vlerësimet e mëparshme (nëse ka) të vlerës në përdorim.

- 131 Një njësi ekonomike duhet të japë informacionet shpjeguese të mëposhtme për humbjet totale nga zhvlerësimi dhe anulimet totale të humbjeve nga zhvlerësimi të njohura gjatë periudhës për të cilën nuk është dhënë informacion në përputhje me paragrafin 130:
- (a) klasat kryesore të aktiveve të prekura nga humbjet nga zhvlerësimi dhe klasat kryesore të aktiveve të prekura nga anulimet e humbjeve nga zhvlerësimi.
  - (b) ngjarjet dhe rrethanat kryesore të cilat kanë çuar në njohjen e këtyre humbjeve nga zhvlerësimi dhe anulimeve të humbjeve nga zhvlerësimi.
- 132 Një njësi ekonomike inkurajohet të japë informacione shpjeguese për supozimet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme të aktiveve (njësive gjeneruese të mjeteve monetare) gjatë periudhës. Megjithatë, paragrafi 134 kërkon që një njësi ekonomike të japë informacion shpjegues për vlerësimet e përdorura për të matur shumën e rikuperueshme të një njësie gjeneruese të mjeteve monetare kur në vlerën kontabël të kësaj njësie gjeneruese të mjeteve monetare përfshihet emri i mirë ose një aktiv jomaterial me jetë të dobishme të papërcaktuar.
- 133 Nëse, në përputhje me paragrafin 84, një pjesë e emrit të mirë të blerë në një kombinim biznesi gjatë periudhës nuk i është shpërndarë një njësie (grupi njësis) gjeneruese të mjeteve monetare në datën e raportimit, duhet të bëhet e ditur shuma e emrit të mirë të pashpërndarë së bashku me arsyet se përse ka mbetur e pashpërndarë kjo shumë.

### **Vlerësimet që përdoren për të matur shumat e rikuperueshme të njësive gjeneruese të mjeteve monetare të cilat përmbajnë emër të mirë ose aktive jomateriale me jetë të dobishme të papërcaktuar**

- 134 Një njësi ekonomike duhet të japë informacionet e kërkuara nga pikat (a)-(f) për çdo njësi (grup njësis) gjeneruese të mjeteve monetare për të cilat vlera kontabël neto e emrit të mirë ose aktiveve afatgjata jomateriale me jetë të dobishme të papërcaktuar që i është shpërndarë kësaj njësie (grupi njësis) është e konsiderueshme në krahasim me vlerën kontabël neto gjithsej të emrit të mirë ose aktiveve afatgjata jomateriale me jetë të papërcaktuar të njësisë ekonomike.
- (a) vlerën kontabël neto të emrit të mirë që i është shpërndarë njësisë (grupit të njësive) gjeneruese të mjeteve monetare;
  - (b) vlerën kontabël neto të aktiveve afatgjata jomateriale me jetë të dobishme të papërcaktuar që i është shpërndarë njësisë (grupit të njësive) gjeneruese të mjeteve monetare;
  - (c) bazën mbi të cilën është përcaktuar shuma e rikuperueshme e njësisë (grupit të njësive) gjeneruese të mjeteve monetare (d.m.th. vlerën në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot për shitje);
  - (d) nëse shuma e rikuperueshme e njësisë (grupit të njësive) gjeneruese të mjeteve monetare është bazuar në vlerën në përdorim:
    - (i) një përshkrim të çdo supozimi kryesor mbi të cilin i ka mbështetur drejtimi parashikimet e veta për flukset monetare për periudhën e mbuluar nga buxhetet/parashikimet më të fundit. Supozimet kryesore janë ato ndaj të cilave është më e ndjeshme shuma e rikuperueshme e njësisë (grupit të njësive) gjeneruese të mjeteve monetare.
    - (ii) një përshkrim të metodës që përdor drejtimi për përcaktimin e vlerës ose vlerave të caktuara për çdo supozim kryesor, nëse e pasqyrojnë ose jo këto vlera përvojën e shkuar, ose, nëse është e përshtatshme, a përputhen ato me burimet e jashtme të informacionit dhe, nëse nuk përputhen, si dhe pse ndryshojnë ato nga përvoja e shkuar apo burimet e jashtme të informacionit.
    - (iii) periudhën gjatë së cilës drejtimi i ka parashikuar flukset monetare në bazë të buxheteve/parashikimeve financiare të aprovuara nga drejtimi dhe, kur përdoret një periudhë më e gjatë se pesë vjet për një njësi (grup njësis) gjeneruese të mjeteve monetare, një shpjegim të arsyes se përse justifikohet kjo periudhë më e gjatë.
    - (iv) normën e rritjes të përdorur për të ekstrapoluar projeksionet e flukseve monetare përtej periudhës së mbuluar nga buxhetet/parashikimet më të fundit dhe justifikimin se përse është përdorur një normë rritjeje e cila është më e madhe se norma mesatare afatgjatë e rritjes për produktet, sektorët e ekonomisë ose vendin apo vendet në të cilët njësi ekonomike ushtron aktivitet, ose për tregun të cilit i kushtohet njësi (grupi i njësive) gjeneruese të mjeteve monetare.

- (v) normën ose normat e skontimit të përdorura për parashikimet e flukseve monetare.
- (e) metodologjinë e përdorur për përcaktimin e vlerës së drejtë minus kostot për shitje, nëse shuma e rikuperueshme e njësisë (grupit të njësive) gjeneruese të mjeteve monetare është bazuar në vlerën e drejtë minus kostot për shitje. Nëse vlera e drejtë minus kostot për shitje nuk përcaktohet përmes përdorimit të një çmimi tregu të monitorueshëm për njësinë (grupin e njësive) gjeneruese të mjeteve monetare, duhet të jepet edhe informacioni shpjegues i mëposhtëm:
- (i) një përshkrim të çdo supozimi kryesor mbi të cilin drejtimi ka mbështetur përcaktimin e vlerës së drejtë minus kostot për shitje. Supozimet kryesore janë ato ndaj të cilave është më e ndjeshme shuma e rikuperueshme e njësisë (grupit të njësive) gjeneruese të mjeteve monetare.
- (ii) një përshkrim të metodës që përdor drejtimi për përcaktimin e vlerës ose vlerave të caktuara për çdo supozim kryesor, nëse e pasqyrojnë ose jo këto vlera përvojën e shkuar, ose, nëse është e përshtatshme, a përputhen ato me burimet e jashtme të informacionit dhe, nëse nuk përputhen, si dhe pse ndryshojnë ato nga përvoja e shkuar apo burimet e jashtme të informacionit.

Nëse vlera e drejtë minus kostot për shitje përcaktohet duke përdorur projektimet e fluksit të skontuar të mjeteve monetare, duhet të jepet edhe informacioni shpjegues i mëposhtëm:

- (iii) periudha për të cilën drejtimi ka projektuar flukset e mjeteve monetare.
- (iv) normën e rritjes të përdorur për ekstrapolim të projeksioneve të fluksit të mjeteve monetare.
- (v) norma (normat) e skontimit të zbatuara për projektimet e fluksit të mjeteve monetare.
- (f) Nëse një ndryshim i mundshëm në një supozim kryesor mbi të cilin e ka bazuar drejtimi përcaktimin e shumës së rikuperueshme të njësisë (grupit të njësive) gjeneruese të mjeteve monetare do të shkaktonte që vlera kontabël neto e njësisë (grupit të njësive) gjeneruese të mjeteve monetare ta kalonte shumën e rikuperueshme të tij:
- (i) shumën me të cilën shuma e rikuperueshme e një njësie (grupi njësish) gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhe se vlera kontabël (neto) e tij.
- (ii) vlera që është caktuar në supozimin kryesor.
- (iii) shumën me të cilën duhet të ndryshojë vlera e caktuar në supozimin kryesor pasi futen efektet e këtij ndryshimi mbi ndryshoret e tjera të përdorura për të matur shumën e rikuperueshme, në mënyrë që shuma e rikuperueshme e njësisë (grupit të njësive) gjeneruese të mjeteve monetare të jetë e barabartë me vlerën kontabël neto të saj.

135

Nëse një pjesë ose e gjithë vlera kontabël neto e emrit të mirë ose aktiveve afatgjata jomateriale me jetë të dobishme të papërcaktuar u shpërndahet disa njësive (grupeve të njësive) gjeneruese të mjeteve monetare, dhe shuma që i shpërndahet në këtë mënyrë çdo njësie (grupi njësish) nuk është e konsiderueshme në krahasim me vlerën kontabël neto gjithsej të emrit të mirë ose aktiveve afatgjata jomateriale me jetë të papërcaktuar të njësive ekonomike, atëherë duhet të jepet informacion shpjegues për këtë fakt së bashku me vlerën kontabël neto totale të emrit të mirë ose të aktiveve jomateriale me jetë të dobishme të papërcaktuar që u është shpërndarë këtyre njësive (grupeve të njësive) gjeneruese të mjeteve monetare. Krahas kësaj, nëse shumat e rikuperueshme të ndonjërit prej këtyre njësive (grupeve të njësive) gjeneruese të mjeteve monetare bazohen në të njëjtin supozim ose të njëjtat supozime dhe vlera kontabël neto totale e emrit të mirë ose e aktiveve afatgjata jomateriale me jetë të dobishme të papërcaktuar që u shpërndahet atyre është e konsiderueshme në krahasim me vlerën kontabël neto gjithsej të emrit të mirë ose aktiveve jomateriale me jetë të papërcaktuar të njësive ekonomike, njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt, së bashku me informacionet e mëposhtme:

- (a) vlerën kontabël neto totale të emrit të mirë që u është shpërndarë këtyre njësive (grupeve të njësive) gjeneruese të mjeteve monetare.
- (b) vlerën kontabël neto totale të aktiveve jomateriale me jetë të dobishme të papërcaktuar që u është shpërndarë këtyre njësive (grupeve të njësive) gjeneruese të mjeteve monetare.
- (c) një përshkrim të supozimit ose supozimeve kryesore.
- (d) një përshkrim të metodës që përdor drejtimi për përcaktimin e vlerës ose vlerave të caktuara në supozimin ose supozimet, nëse e pasqyrojnë ose jo këto vlera përvojën e shkuar, ose, nëse është e përshtatshme, përputhen ato me burimet e jashtme të informacionit dhe, nëse nuk përputhen, si dhe pse ndryshojnë ato nga përvoja e shkuar apo burimet e jashtme të informacionit.
- (e) nëse një ndryshim i mundshëm i arsyeshëm në supozimin ose supozimet kryesore do të bënte që totali i vlerave kontabël neto të njësive (grupeve të njësive) gjeneruese të mjeteve monetare t'ia kalonte totalit të shumave të rikuperueshme të tyre:
- (i) shumën me të cilën shumat e rikuperueshme të njësive (grupeve të njësive) gjeneruese të mjeteve monetare janë më të mëdha se totali i vlerave kontabël neto të tyre.
- (ii) vlera ose vlerat që janë caktuar në supozimin ose supozimet kryesore.
- (iii) shumën me të cilën duhet të ndryshojë vlera ose vlerat e caktuara supozimit ose supozimeve kryesore pasi futen efektet e këtij ndryshimi mbi ndryshoret e tjera të përdorura për të matur shumën e rikuperueshme, në mënyrë që totali i shumave të rikuperueshme të njësive (grupeve të njësive) gjeneruese të mjeteve monetare të jetë e barabartë me totalin e vlerave kontabël neto të tyre.
- 136 Mënyra e llogaritjes së hollësishme më të fundit të bërë në një periudhë të mëparshme për shumën e rikuperueshme të një njësie (grupi njësish) gjeneruese të mjeteve monetare mund të mbartet dhe të përdoret, në përputhje me paragrafin 24 ose 99, në testin e zhvlerësimit për këtë njësi (grup njësish) gjeneruese të mjeteve monetare në periudhën aktuale, me kusht që të jenë plotësuar kriteret e përcaktuara. Nëse veprohet kështu, informacioni për këtë njësi (grup njësish) gjeneruese të mjeteve monetare i cili përfshihet në dhënien e informacioneve shpjeguese që kërkohen nga paragrafët 134 dhe 135 lidhen me llogaritjen e mbartur të shumës së rikuperueshme.
- 137 Shembulli sqarues 9 shpjegon dhënien e informacioneve shpjeguese që kërkojnë paragrafët 134 dhe 135.

## Dispozita kalimtare dhe data e hyrjes në fuqi

- 138 [Hequr]
- 139 Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë Standard:
- (a) për emrin e mirë dhe aktivet jomateriale të blera në kombinime biznesi për të cilat data e marrëveshjes është 31 mars 2004 e në vijim; dhe
- (b) për të gjitha aktivet e tjera në mënyrë prospektive, prej fillimit të periudhës së parë vjetore që fillon më datën 31 mars 2004 e në vijim.
- 140 Njësitë ekonomike për të cilat zbatohet paragrafi 139 inkurajohen të zbatojnë kërkesat e këtij Standardi para datës së hyrjes në fuqi të tij parashikuar në paragrafin 139. Megjithatë, në qoftë se njësia ekonomike e zbaton këtë Standard para këtyre datave të hyrjes në fuqi, ajo zbaton edhe SNRF 3 dhe SNK 38 (të rishikuar në 2004) në të njëjtën kohë.
- 140A SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* (i rishikuar në 2007) ka ndryshuar terminologjinë e përdorur në të gjitha SNRF-të. Përveç kësaj, kanë ndryshuar paragrafët 61, 120, 126 dhe 129. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat kontabël që fillon më datën 1 janar 2009 e në vijim. Nëse njësia ekonomike e zbaton SNK 1 (të rishikuar në 2007) për një periudhë më të hershme, atëherë do të zbatohen edhe ndryshimet për këtë periudhë më të hershme.
- 140B Në SNRF 3 (i rishikuar në 2008) kanë ndryshuar paragrafët 65, 81, 85 dhe 139, janë hequr paragrafët 91–95 dhe 138 dhe është shtuar Shtojca C. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 korrik 2009 e në vijim. Nëse njësia ekonomike e zbaton SNRF 3 (e rishikuar në 2008) për një periudhë më të hershme, atëherë do të zbatohen ndryshimet edhe për këtë periudhë të hershme.
- 140C Paragrafi 134(e) është ndryshuar si rezultat i *Përmirësimeve në SNRF-të* të publikuara në maj 2008. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më datë n 1 janar 2009 e në vijim. Lejohet zbatimi para kë saj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton ndryshimin për një periudhë më të hershme ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

- 140D Në *Koston e një investimi në një filial, njësi të bashkëkontrolluar ose pjesëmarrje* (Ndryshimet në SNRF 1 *Zbatimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe SNK 27*), publikuar në maj 2008, është shtuar paragrafi 12(h). Një njësi ekonomike duhet ta zbatojë këtë ndryshim në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2009 e në vijim. Lejohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet përkatëse në paragrafët 4 dhe 38A të SNK 27 për një periudhë më të hershme, ajo duhet të zbatojë ndryshimin në paragrafin 12(h) në të njëjtën kohë.

## **Shfuqizimi i SNK 36 (publikuar në 1998)**

---

- 141 Ky Standard zëvendëson SNK 36 *Zhvlerësimi i aktiveve* (publikuar në 1998).



# Shtojcë A

## Përdorimi i teknikave të vlerës aktuale për të matur vlerën në përdorim

*Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e Standardit. Në të jepen udhëzime të tjera shtesë për përdorimin e teknikave të vlerës aktuale në matjen e vlerës në përdorim. Megjithëse udhëzimi përdor termin “aktiv”, ky term zbatohet njësoj edhe për një grup aktivësh që përbëjnë një njësi gjeneruese të mjeteve monetare.*

### Përbërësit e një matjeje të vlerës aktuale

- A1 Së bashku, elementet e mëposhtëm mbulojnë diferencat ekonomike midis aktiveve:
- (a) një vlerësim i flukseve monetare të ardhshme, ose në rastet më të ndërlikuara, e serive të flukseve monetare të ardhshme që pret të nxjerrë njësi ekonomike nga aktivi;
  - (b) pritshmëritë në lidhje me variacionet e ndryshme të shumës apo kohës së këtyre flukseve monetare;
  - (c) vlera në kohë e parasë, e përfaqësuar nga norma aktuale e interesit të lirë nga rreziku i tregut;
  - (d) çmimi për mbartjen e pasigurisë së vetvetishme të aktivitetit; dhe
  - (e) faktorë të tjerë, ndonjëherë të paignifikueshëm (si për shembull mungesa e likuiditetit), të cilët pjesëmarrësit e tregut do t'i pasqyronin në vendosjen e çmimit të flukseve monetare të ardhshme që njësi ekonomike pret të nxjerrë nga aktivi.
- A2 Kjo shtojcë krahason dy metoda të llogaritjes së vlerës aktuale, secila prej të cilave mund të përdoret për të vlerësuar vlerën në përdorim të një aktivi, në varësi të rrethanave. Sipas metodës “tradicionale”, në normën e skontimit përfshihen rregullimet për faktorët (b)-(e) që përshkruhen në paragrafin A1. Sipas metodës së “flukseve monetare të pritshme”, faktorët (b), (d) dhe (e) shkaktajnë rregullime për të arritur në flukset monetare të pritshme të rregulluara me rrezikun. Cilado qoftë metoda që përdor një njësi ekonomike për të pasqyruar pritshmëritë në lidhje me variacionet e mundshme të shumës ose afatit të flukseve monetare të ardhshme, rezultati duhet të jetë i tillë që të pasqyrojë vlerën aktuale të pritshme të flukseve monetare të ardhshme, d.m.th. mesataren e ponderuar të të gjitha rezultateve të mundshme.

### Parimet e përgjithshme

- A3 Teknikat e përdorura për të vlerësuar flukset monetare të ardhshme dhe normat e interesit ndryshojnë nga njera situatë në tjetrën, në varësi të rrethanave në të cilat ndodhet aktivi në fjalë. Megjithatë, parimet e mëposhtme rregullojnë çdo zbatim të teknikave të vlerës aktuale gjatë matjes së aktiveve:
- (a) normat e interesave të përdorura për të skontuar flukset monetare duhet të pasqyrojnë supozimet të cilat përputhen me ato që kanë të bëjnë me flukset monetare të vlerësuara. Përndryshe, efekti i disa prej supozimeve do të llogaritet dy herë ose nuk do të merret fare parasysh. Për shembull, një normë skontimi prej 12 përqind mund të zbatohet për flukset monetare kontraktuale të një huaje të arkëtueshme. Kjo normë pasqyron pritshmërinë e moszbatimeve të ardhshme të kontratave të huave me karakteristika të veçanta. Por kjo normë prej 12 përqind nuk duhet të përdoret për të skontuar flukset monetare të pritshme, sepse këto flukse monetare i pasqyrojnë tashmë supozimet për moszbatimet e kontratave në të ardhmen.
  - (b) flukset monetare të vlerësuara dhe normat e skontimit duhet të jenë të lira si nga paragjykimi, ashtu edhe nga faktorë që nuk kanë lidhje me aktivin në fjalë. Për shembull, të minimizosh qëllimisht flukset monetare neto të vlerësuara si rritje e fitimprurjes së ardhshme të dukshme të një aktivi do të thotë që në matje futet një paragjykim.
  - (c) flukset monetare të vlerësuara ose normat e skontimit duhet të pasqyrojnë vargun e rezultateve të mundshme dhe jo një rezultat të vetëm më të mundshëm apo shumën e mundshme minimale ose maksimale.

## Metoda tradicionale dhe metoda e flukseve monetare të pritshme për vlerën aktuale

### Metoda tradicionale

- A4 Zbatimet kontabël të vlerës aktuale historikisht kanë përdorur një paketë të vetme fluksesh monetare të vlerësuar dhe një normë të vetme skontimi, shpesh e përshkruar si “norma përpjesëtimore me rrezikun”. Në praktikë, metoda tradicionale supozon se një normë e vetme skontimi mund t’i përfshijë të gjitha pritshmëritë për flukset monetare të ardhshme dhe primin e duhur për rrezikun. Për rrjedhojë, metoda tradicionale e vë theksin më tepër tek zgjedhja e normës së skontimit.
- A5 Në disa rrethana, siç janë ato në të cilat mund të ndiqen aktivet e krahasueshme në treg, është relativisht e lehtë për t’u zbatuar një metodë tradicionale. Për aktivet me flukse monetare kontraktuale, kjo metodë përputhet me mënyrën në të cilën i përshkruajnë aktivet pjesëmarrësit në treg, siç ndodh në rastin e një “obligacioni 12 përqindësh”.
- A6 Megjithatë, metoda tradicionale mund të mos u japë zgjidhje siç duhet disa problemeve komplekse të matjes, siç është për shembull matja e aktiveve jofinanciare për të cilët nuk ekziston asnjë treg për zërin ose asnjë zë i krahasueshëm. Një kërkim i duhur për “normën përpjesëtimore me rrezikun” kërkon një analizë të paktën të dy zërave: një aktiv i cili ekziston në treg dhe ka një normë interesi të monitorueshme dhe aktiv i që po matet. Norma e duhur e skontimit për flukset monetare që po maten duhet të dalë nga norma e monitorueshme e interesit për aktivin tjetër. Që të nxirret kështu kjo normë, karakteristikat e flukseve monetare të aktivit tjetër duhet të jenë të ngjashme me ato të aktivit që po matet. Për rrjedhojë, matësi duhet të veprojë si më poshtë:
- të identifikojë kategorinë e flukseve monetare që do të skontohej;
  - të identifikojë një aktiv tjetër në treg i cili duket se ka karakteristika të ngjashme të flukseve monetare;
  - të krahasojë kategoritë e flukseve monetare nga këta dy zëra për t’u siguruar që janë të ngjashëm (për shembull, nëse janë të dyja flukse monetare kontraktuale, ose nëse njëra kategori ka flukse monetare kontraktuale, ndërsa tjetra flukse monetare të vlerësuar);
  - të vlerësojë nëse ka një element në njërin prej zërave i cili nuk është i pranishëm në tjetrin (për shembull, nëse njëri është më pak likuid se tjetri); dhe
  - të vlerësojë nëse të dy kategoritë e flukseve monetare kanë të ngjarë të sillen (d.m.th. të ndryshojnë) në mënyrë të ngjashme në kushte ekonomike të ndryshuara.

### Metoda e flukseve monetare të pritshme

- A7 Metoda e flukseve monetare të pritshme, në disa situata, është një instrument matjeje më i efektshëm se metoda tradicionale. Gjatë kryerjes së një matjeje, metoda e flukseve monetare të pritshme përdor të gjitha pritshmëritë për flukset monetare të mundshme, në vend të vetëm një fluksi monetar më të mundshëm. Për shembull, një fluks monetar mund të jetë 100 NJM, 200 NJM ose 300 NJM, përkatësisht me probabilitet 10 përqind, 60 përqind dhe 30 përqind. Fluksi monetar i pritshëm është 220 NJM. Pra, metoda e flukseve monetare të pritshme ndryshon nga metoda tradicionale, sepse përqendrohet në analizën e drejtpërdrejtë të flukseve monetare në fjalë dhe në paraqitjen më të qartë të supozimeve të përdorura për matjen.
- A8 Metoda e flukseve monetare të pritshme mundëson edhe përdorimin e teknikave të vlerës aktuale kur është i pasigurtë afati i flukseve monetare. Për shembull, një fluks monetar prej 1,000 NJM, mund të arkëtohet pas një viti, dy vjetësh ose tre vjetësh me probabilitet, përkatësisht, 10 përqind, 60 përqind dhe 30 përqind. Shembulli i mëposhtëm tregon llogaritjen e vlerës aktuale të pritshme në këtë situatë.

Vlera aktuale e 1,000 NJM pas 1 viti me 5%	952.38	NJM
Probabiliteti	10.00%	95.24NJM
Vlera aktuale e 1,000 NJM pas 2 vjetësh me 5.25%	902.73	NJM
Probabiliteti	60.00%	541.64NJM
Vlera aktuale e 1,000 NJM pas 3 vjetësh me 5.50%	851.61	NJM

Probabiliteti	30.00%	255.48NJM
Vlera aktuale e pritshme		892.36NJM

- A9 Vlera aktuale e pritshme prej 892.36 NJM ndryshon nga nocioni tradicional i vlerësimit më të mirë prej 902.73 NJM (probabiliteti 60 përqind). Një llogaritje tradicionale e vlerës aktuale e zbatuar në këtë shembull kërkon një vendim se cila prej afateve të mundshme të flukseve monetare të përdoret dhe, po kështu, nuk do t'i pasqyronte probabilitetet e afateve të tjera. Kjo ndodh ngaqë norma e skontimit në një llogaritje tradicionale të vlerës aktuale nuk mund t'i pasqyrojë pasiguritë në lidhje me kohën e ndodhjes.
- A10 Përdorimi i probabiliteteve është një element thelbësor i metodës së flukseve monetare të pritshme. Disa shtrojnë pyetjen nëse caktimi i probabiliteteve tepër subjektiv për vlerësimet mund të sugjerojë një saktësi më të madhe nga ajo që ekziston në të vërtetë. Megjithatë, zbatimi i duhur i metodës tradicionale (sikurse përshkruhet në paragrafin A6) kërkon të njëjtat vlerësime dhe subjektivitet pa siguruar transparencën e metodës së flukseve monetare të pritshme.
- A11 Në një farë mënyrë, shumë vlerësime të zhvilluara në praktikën e tanishme i përfshijnë disa elemente të flukseve monetare të pritshme. Gjithashtu, kontabilistët shpesh gjenden përballë nevojës për ta matur një aktiv duke përdorur informacione të kufizuara për probabilitetin e flukseve monetare të mundshme. Për shembull, një kontabilist mund të gjendet në një situatë si më poshtë:
- Shuma e vlerësuar bie diku midis 50 NJM dhe 250 NJM, por asnjëra prej vlerave në këtë varg nuk mund të quhet si vlera me probabilitetin më të madh. Në bazë të këtij informacioni të kufizuar, fluksi monetar i pritshëm i vlerësuar është  $150 \text{ NJM } [(50 + 250)/2]$ .
  - Shuma e vlerësuar bie diku midis 50 NJM dhe 250 NJM, dhe vlera më e mundshme është 100 NJM. Mirëpo, nuk dihet probabiliteti që mund t'i caktohet secilës vlerë. Në bazë të këtij informacioni të kufizuar, fluksi monetar i pritshëm i vlerësuar është  $133.33 \text{ NJM } [(50 + 100 + 250)/3]$ .
  - Vlera e çmuar do të jetë 50 NJM (10 përqind probabilitet), 250 NJM (probabiliteti 30 përqind), ose 100 NJM (probabilitet 60 përqind). Në bazë të këtij informacioni të kufizuar, fluksi monetar i pritshëm i vlerësuar është  $140 \text{ NJM } [(50 \times 0.10) + (250 \times 0.30) + (100 \times 0.60)]$ .
- Në secilin rast, fluksi monetar i pritshëm i vlerësuar ka mundësi të japë një vlerësim më të mirë të vlerës në përdorim se vlera minimale, vlera maksimale apo vlera më e mundshme e marrë veçmas.
- A12 Zbatimi i një metode të flukseve monetare të pritshme i nënshtrohet një kufizimi të raportit kosto-përfitim. Në disa raste, një njësi ekonomike mund të ketë mundësi të shikojë të dhëna të hollësishme dhe mund të zhvillojë shumë skenarë të flukseve monetare. Në raste të tjera, një njësi ekonomike mund të jetë në gjendje të hartojë më shumë se disa evidenca të përgjithshme në lidhje me ndryshueshmërinë e flukseve monetare pa krijuar kosto të konsiderueshme. Njësia ekonomike duhet të ekuilibrojë koston e gjetjes së informacionit shtesë kundrejt besueshmërisë shtesë që do t'i jepte matjes ky informacion.
- A13 Disa janë të mendimit se teknikat e flukseve monetare të pritshme nuk janë të përshtatshme për matjen e një zëri të vetëm ose të një zëri me një numër të kufizuar rezultatesh të mundshme. Si shembull, ata japin një aktiv me dy rezultate të mundshme: probabilitet 90 përqind se fluksi monetar do të jetë 10 NJM dhe 10 përqind probabilitet se fluksi monetar do të jetë 1,000 NJM. Këta persona vërejnë se fluksi monetar i pritshëm në këtë shembull është 100 NJM dhe e kritikojnë këtë rezultat se ai nuk përfaqëson asnjërin prej shumave që do të mund të paguhen në fund të fundit.
- A14 Opinione të tilla si ky më sipër pasqyrojnë mospajtimin bazë me objektivin e matjes. Nëse objektivi është akumulimi i kostove që do të kryhen, flukset monetare të pritshme mund të mos japin një vlerësim të besueshëm dhe përfaqësues të kostos së pritur. Megjithatë, ky Standard ka të bëjë me matjen e shumës së rikuperueshme të një aktivi. Shuma e rikuperueshme e aktivit në këtë shembull nuk ka mundësi të jetë 10 NJM, edhe pse kjo shumë mund të jetë fluksi monetar më i mundshëm. Kjo ndodh ngaqë një matje prej 10 NJM nuk e përfshin pasigurinë e fluksit monetar në matjen e aktivit. Në vend të kësaj, fluksi monetar i pasigurt paraqitet sikur të jetë një fluks monetar i sigurt. Asnjë njësi ekonomike racionale nuk do ta shiste një aktiv me këto karakteristika për 10 NJM.

## Norma e skontimit

- A15 Cilado qoftë metoda që njësia ekonomike vendos të përdorë për matjen e vlerës në përdorim të një aktivi, normat e interesit të përdorura për t'i skontuar flukset monetare nuk duhet t'i pasqyrojnë rreziqet për të cilat janë rregulluar flukset monetare të vlerësuara. Përndryshe, efekti i disa prej supozimeve do të llogaritet dy herë.

- A16. Kur një normë që është specifike për një aktiv nuk mund të gjendet drejtpërdrejt nga tregu, një njësi ekonomike përdor zëvendësues për të bërë një vlerësim të normës së skontimit. Qëllimi është të çmohet, në një shkallë sa më të madhe, vlerësimi i tregut për:
- (a) vlerën në kohë e pasasë për periudhat deri në fund të jetës së dobishme të aktivit; dhe
  - (b) faktorët (b), (d) dhe (e) që përshkruhen në paragrafin A1, për aq sa këta faktorë nuk kanë shkaktuar rregullime gjatë nxjerrjes së llogaritjeve për flukset monetare të vlerësuara.
- A17 Si pikënisje në bërjen e një vlerësimi të tillë, njësi ekonomike mund të marrë parasysh normat e mëposhtme:
- (a) koston mesatare të ponderuar të kapitalit të njësisë ekonomike duke përdorur teknika të tilla si “Modeli i vendosjes së çmimit të aktiveve kapitale”;
  - (b) normën e huamarrjes shtesë të njësisë ekonomike; dhe
  - (c) norma të tjera huamarrjeje të tregut.
- A18 Megjithatë, këto norma duhet të rregullohen:
- (a) për të pasqyruar mënyrën se si do t’i vlerësonte tregu rreziqet specifike që shoqërojnë flukset monetare të vlerësuara të aktivit; dhe
  - (b) për të përjashtuar rreziqet të cilat nuk kanë lidhje me flukset monetare të vlerësuara të aktivit ose për të cilat janë rregulluar flukset monetare të vlerësuara.
- Duhet të kihet parasysh rreziqe të tilla si rreziku i vendit, rreziku i valutës dhe rreziku i çmimit.
- A19 Norma e skontimit është e pavarur nga struktura e kapitalit të njësisë ekonomike dhe mënyra se si e ka financuar blerjen e aktivit njësi ekonomike, sepse flukset monetare të ardhshme që priten të vijnë nga një aktiv nuk varen nga mënyra se si e ka financuar blerjen e aktivit njësi ekonomike.
- A20 Paragrafi 55 kërkon që norma e skontimit e përdorur të jetë një normë përpara tatimit. Për rrjedhojë, kur baza e përdorur për të çmuar normën e skontimit është pas tatimit, kjo bazë rregullohet për të pasqyruar normën përpara tatimit.
- A21 Normalisht, një njësi ekonomike përdor një normë të vetme skontimi për vlerësimet e vlerës në përdorim të një aktivit. Megjithatë, një njësi ekonomike përdor norma të veçanta skontimi për periudha të ndryshme të ardhshme ku vlera në përdorim është e ndjeshme ndaj ndryshimit në rreziqet për periudha të ndryshme ose ndaj strukturës kohore të normave të interesit.

# Shtojca B

[Ndryshimi nuk është i zbatueshëm për të thjeshtuar Standardet]

## Shtojca C

# Testi i zhvlerësimit për njësitë gjeneruese të mjeteve monetare që kanë emër të mirë dhe interesat jokontrolluese

*Kjo shtojcë nuk është pjesë përbërëse e Standardit.*

- C1 Në përputhje me SNRF 3 (i rishikuar në 2008), blerësi mat dhe njeh emrin e mirë në datën e blerjes si një tejkallim të (a) mbi (b), që përfaqësojnë:
- (a) totali i:
    - (i) shumës së transferuar të matur në përputhje me SNRF 3, i cili në përgjithësi kërkon vlerën e drejtë në datën e blerjes;
    - (ii) shumës së çdo interesi jokontrollues, në njësinë ekonomike që blihet, e matur në përputhje me SNRF 3; dhe
    - (iii) vlerës së drejtë në datën e blerjes e interesit në kapitalin neto të mbajtur më parë nga blerësi në njësinë ekonomike që blihet, në një kombinim biznesi të kryer me faza.
  - (b) shumat neto të aktiveve dhe pasiveve të identifikueshëm në datën e blerjes të matur në përputhje me SNRF 3.

### Shpërndarja e emrit të mirë

- C2 Paragrafi 80 i këtij Standardi kërkon që emri i mirë i blerë në një kombinim biznesi të shpërndahet tek çdo njësi gjeneruese mjeteve monetare, ose grup njësisish gjeneruese të mjeteve monetare të blerësit, të cilat priten të përfitojnë nga sinergjitë e kombinimit, pavarësisht nëse këtyre njësisive apo grupeve të njësisive u janë caktuar aktive apo pasive të tjera të njësisë ekonomike të blerë. Është e mundur që disa nga sinergjitë që rrjedhin nga një kombinim biznesi të shpërndahen në një njësi gjeneruese të mjeteve monetare në të cilën interesi jokontrollues nuk ka ndonjë interes.

### Testimi për zhvlerësim

- C3 Testimi për zhvlerësim përfshin krahasimin e shumës së rikuperueshme të një njësie gjeneruese të mjeteve monetare me vlerën kontabël neto të saj.
- C4 Nëse një njësi ekonomike mat interesat jokontrolluese si interesat e saj të përpjesëtuar në aktivet neto të identifikueshëm të një filiali në datën e blerjes, sesa me vlerën e drejtë, atëherë emri i mirë që u takon interesave jokontrolluese përfshihet në shumën e rikuperueshme të njësisë gjeneruese përkatëse të mjeteve monetare, por nuk njihet në pasqyrat financiare të konsoliduara të mëmës. Si rrjedhim, një njësi ekonomike do të rriste vlerën kontabël neto të emrit të mirë të shpërndarë tek njësia për të përfshirë emrin e mirë që i takon interesit jokontrollues. Kjo vlerë kontabël neto e rregulluar krahasohet pastaj me shumën e rikuperueshme të njësisë për të përcaktuar nëse njësia gjeneruese e mjeteve monetare është e zhvlerësuar.

### Shpërndarja e humbjes nga zhvlerësimi

- C5 Paragrafi 104 kërkon që çdo humbje nga zhvlerësimi duhet të shpërndahet së pari për të zvogëluar vlerën kontabël neto të emrit të mirë të shpërndarë tek njësia dhe pastaj tek aktivet e tjera të njësisë në përpjesëtim me vlerën kontabël neto të secilit aktiv të njësisë.
- C6 Nëse një filial, ose pjesë e një filiali, me një interes jokontrollues është në vetvete një njësi gjeneruese e mjeteve monetare, humbja nga zhvlerësimi shpërndahet midis mëmës dhe interesit jokontrollues mbi të njëjtën bazë mbi të cilën është shpërndarë fitimi ose humbja.
- C7 Nëse një filial, ose pjesë e një filiali, me një interes jokontrollues është pjesë e një njësie gjeneruese më të madhe mjeteve monetare, humbjet nga zhvlerësimi i emrit të mirë shpërndahen tek pjesët e njësisë që kanë një interes jokontrollues dhe tek ato që nuk kanë. Humbjet nga zhvlerësimi duhet të shpërndahen tek pjesët e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare deri:

- (a) në masën që zhvlerësimi lidhet me emrin e mirë në njësinë gjeneruese të mjeteve monetare, vlerat kontabël neto relative e emrit të mirë të pjesëve para zhvlerësimit; dhe
- (b) në masën që zhvlerësimi lidhet me aktivet e identifikueshëm në njësinë gjeneruese të mjeteve monetare, vlerat kontabël neto relative të aktiveve të identifikueshme neto të pjesëve para zhvlerësimit. Një zhvlerësim i tillë shpërndahet tek aktivet e pjesëve të secilës njësisë në përpjesëtim me shumat kontabël neto të çdo aktivi në pjesë.

Në ato pjesë që kanë një interes jokontrollues, humbja nga zhvlerësimi shpërndahet midis mëmës dhe interesit jokontrollues mbi të njëjtën bazë që është shpërndarë fitimi ose humbja.

- C8 Nëse një humbje nga zhvlerësimi i ngarkueshëm tek një interes jokontrollues lidhet me emrin e mirë që nuk është njohur në pasqyrat financiare të konsoliduara të mëmës (shih paragrafin C4), ky zhvlerësim nuk njihet si një humbje nga zhvlerësimi i emrit të mirë. Në këto raste, vetëm humbja nga zhvlerësimi që lidhet me emrin e mirë që i është shpërndarë mëmës njihet si një humbje nga zhvlerësimi i emrit të mirë.
- C9 Shembulli 7 sqarues trajton testimin e zhvlerësimit të një njësie gjeneruese mjeteve monetare jo tërësisht të zotëruar me emër të mirë.